



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 1 KORRIK 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 1. JULA 2019. GODINE**

**KORRIK - JUL
2019**

Rendi i ditës

1. Situata aktuale e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë - angazhimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për të drejtat dhe vështirësitë e tyre

Dnevni red

1. Trenutno stanje Albanaca u Preševu, Bujanovcu i Medveđi - angazhovanje institucija Republike Kosova za njihova prava i poteškoće

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 43 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 59 deputetë.

Procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Situata aktuale e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, angazhimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për të drejtat dhe vështirësitë e tyre

Të nderuar deputetë,

43 deputetë kanë parashtruar këtë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme lidhur me situatën aktuale të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, angazhimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për të drejtat dhe vështirësitë e tyre.

Ftoj zotin Ismajl Kurteshi, që në emër të propozuesit të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar seanca e jashtëzakonshme.

Më fal zoti Kurteshi, paska një reagim. Urdhëro zoti Hoti! Sigurisht për çështje të rendit të ditës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Lidhur me rendin e ditës, ne të premtën e kemi pasur një seancë, e cila ka përfunduar, por nuk është hedhur në votim propozim-vendimi që e kemi propozuar.

Unë i lus grupet parlamentare që për një gjysmë ore le të ulen bashkë nëse mund ta harmonizojnë propozim-vendimin dhe mundësisht për gjysmë ore ta hidhni pastaj në votim atë propozim-vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Hoti e dha një propozim. Unë kisha kërkuar që të bëhen bashkë grupet parlamentare në mënyrën që pastaj ta vejmë në votim për mocion procedural, ta futim në ditën e sotme edhe votimin e asaj rezolute, t'i kemi paraprakisht të gatshme të dyja bashkë.

Zoti Kurteshi, fjala për ju.

Zoti Hoti, ndërmerrni masat me grupet parlamentare, pastaj menjëherë në momentin që janë 61 deputetë e vej në votim, edhe mocionin procedural e fusim në votim pastaj.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Gjatë vizitës së gjashtë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Komisioni për Arsim dhe Komisioni për Administratë më 5 dhe 6 qershor të këtij viti në Medvegjë e Bujanoc dhe Preshevë, jemi informuar për së afërmi me sfidat që po përballen mbi 55 mijë shqiptarë që jetojnë në trojet e tyre etnike në Luginën e Preshevës.

Deputetët që e kanë vizituar Luginën edhe në vitin 2015 e kanë vërejtur se kushtet e jetës për shqiptarët e Luginës janë përkeqësuar në krahasim me katër vjet më parë.

Gjatë vizitës është konstatuar se me programet aktuale shkollore nuk mund të ruhet kultura, tradita dhe identiteti kombëtar i shqiptarëve. Edukimi i mirëfilltë i komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës po pengohet nga institucionet e shtetit të Serbisë.

Numri i nxënësve e qytetarëve në përgjithësi në Luginë është zvogëluar, problemi i teksteve shkollore nuk është zgjidhur, të diplomuarit në Kosovë bredhin rrugëve të Luginës për shkak të mosnjohjes së diplomave nga ana e shtetit të Serbisë. Bibliotekat e shkollave në Luginë janë shumë të varfra, nevojë emergjente e shkollave të Luginës së Preshevës është sigurimi i së paku nga një teksti shkollor për çdo lëndë mësimore për shkollat fillore dhe të mesme.

Gjatë vizitës në Këshillin Kombëtar Shqiptar në Bujanoc kemi mësuar se Këshilli është reduktuar nga 29 në 15 anëtarë dhe buxheti i tij është zvogëluar për 40%, nxënësit në mungesë të teksteve shkollore kryesisht mësojnë nga shënimet, numri i të punësuarve në administratën e shtetit është simbolik. Në spitalin regjional të Vranjës, në të cilin punojnë rreth 600 punëtorë, e ku 40% të pacientëve janë shqiptar është i punësuar vetëm një shqiptar.

Në Ministrinë e Arsimit të Serbisë punon vetëm një shqiptar, kurse në Kadastër nuk punon asnjë shqiptar.

Në komunën e Medvegjës nga 87 të punësuar, vetëm 3 janë shqiptarë, në Preshevë është mbyllur Gjykata Themelore, në Medvegjë është mbyllur dega e Fakultetit Ekonomik, në Luginë janë rritur gjambat ndaj atyre që jashtëligjshëm, sipas ligjeve të Serbisë, përdorin simbolet kombëtare.

Në takim në Këshillin Kombëtar është kërkuar të respektohet referendumi i shqiptarëve të Luginës i vitit 2002.

Çështja e Luginës të bëhet pjesë e pandashme e dialogut me Serbinë në Bruksel ose kudo qoftë tjetër.

Të informohen institucionet dhe forumet ndërkombëtare për politikën diskriminuese të shtetit të Serbisë që po ushtron ndaj shqiptarëve etnikë në Luginën e Preshevës, të insistohet në parimin e reciprocitetit në mes të shqiptarëve të Luginës dhe serbëve në Kosovë. Të ndërpritet menjëherë pasivizimi i adresave të shqiptarëve, sepse është konstatuar që pasivizimi i adresave në Luginë paraqet pastrim etnik të shqiptarëve nga Lugina.

Është kërkuar jetësim i Memorandumit të bashkëpunimit në mes të Këshillit Kombëtar dhe Ministrisë së Kulturës.

Po ashtu është kërkuar pajisje me dokumente të shqiptarëve të Luginës që jetojnë në Kosovë, është kërkuar përkrahje institucionale Këshillit Kombëtar, është kërkuar rritja e kuotave për studentët nga Lugina në universitetet publike të Kosovës, është kërkuar t'u lejohet mjekëve që diplomojnë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë ta kryejnë praktikën në Kosovë dhe të pajisen me certifikata pune. Është kërkuar që ministrinë e Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë ta investojnë nga një projekt në vit në Luginë.

Dhe, në fund, të përkrahët kultura, mediat dhe sporti në Luginë.

Kolegë të nderuar,

Nëse institucionet e Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë nuk fillojnë menjëherë t'i përkrahin politikisht dhe financiarisht përmes projekteve të ndryshme shqiptarët që jetojnë në Luginë, ata do të detyrohen të ikin nga trojet e tyre shekullore për shkak të politikës diskriminuese të Serbisë.

Prandaj, duhet ta dinë institucionet e dy shteteve shqiptare se është koha e fundit që nga fjalët të kalojnë në vepra. Përndryshe, fajin për zbrazjen e Luginës sa bie mbi Serbinë, për politikën e saj shoviniste, pothuajse po aq do të bie mbi institucione tona që nuk po përpiqen ta pengojnë këtë projekt ugurzi të Serbisë.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë.

Dhe, në fund do t'i lexoj edhe rekomandimet, me të cilat jemi pajtuar unë dhe zoti Hasani, kryetari i Komisionit të Arsimit, të cilat natyrisht që do të jenë objekt i trajtimit edhe i përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Po filloj t'i lexoj këto.

1. Çështja e Luginës të bëhet pjesë e përhershme e dialogut me Serbinë në Bruksel ose kudo qoftë tjetër.

2. Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë t'i informojnë institucionet dhe forumet ndërkombëtare për politikën diskriminuese të shtetit të Serbisë që po ushtron ndaj shqiptarëve etnikë në Luginën e Preshevës dhe të kërkojnë nga të njëjtit që të angazhohen për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve.
3. Të insistohet në parimin e reciprocitetit në mes të shqiptarëve të Luginës dhe serbëve në Kosovë.
4. Të ndërpritet menjëherë pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.
5. Të respektohet referendumi i shqiptarëve të Luginës i vitit 2002.
6. Të pajisen me tekste shkollore, mjete pune dhe lektyra shkollore shkollat shqipe në Luginë.
7. Të jetësohet memorandumi i bashkëpunimit në mes të Këshillit Kombëtar Shqiptar dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Qeverisë së Kosovës.
8. Që shqiptarët e Luginës që jetojnë në Kosovë të pajisen me dokumente të nevojshme nga institucionet e Republikës së Kosovës.
9. Institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë ta përkrahin Këshillin kombëtar edhe në aspektin financiar.
10. Të rriten kuotat për studentët nga Lugina në Universitetin Publik të Kosovës.
11. T'ju lejohet mjekësve që diplomojnë në Fakultetet e Mjekësisë në Prishtinë ta kryejnë praktikën në Kosovë dhe të pajisen me certifikata pune.
12. Ministrinë e Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë të investojnë në projekte të ndryshme në Luginë dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet e kulturës dhe sportit të Luginës së Preshevës.

Këto ishin edhe propozimet që i kemi bërë unë dhe zoti Nait Hasani. Në fund të seancës edhe ne do të kërkojmë që ta bëjmë një grup të përfaqësuesve të të gjitha grupeve parlamentare dhe bashkërisht do të dalim me konkluzione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Zoti Hasani, në emër po ashtu të propozuesit kanë kërkuar të dytë, nuk besoj që ka reagim, edhe pse me Rregullore nuk është e domosdoshme të dytë.

Urdhëro, zoti Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Unë atë që i tha Ismajl Kurteshi, kryetari i Komisionit për Arsim i mbështes, se kanë qenë kërkesa të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, ato kërkesa na i kanë prezantua ata atje. Kanë kërkuar nga ne që të prezantojmë në seancën e Kuvendit, të kërkojmë mbështetje, të kërkojmë nga Qeveria dhe institucionet tonë pikërisht për këto kërkesa. Kërkesat e tyre kanë qenë edhe në Medvegjë, që është një shkollë e vjetër “Zenel Hajdini” që e mban emrin e këtij heroit të popullit.

Po çështja është që ajo shkollë ka pak nxënës dhe ka pak mësimdhënës dhe pak inventar ose thuajse aspak.

Çështje më e rëndësishme e Medvegjës ka qenë çështja e regjistrimit të popullsisë dhe të fshirja nga regjistri që e bën Administrata e Medvegjës.

Prandaj, kërkesë e tyre ka qenë që të ndihmohet ajo pjesë që është me një territor më të madh se sa Prishtina si territor.

Ndërsa me numër të banorëve sillet numri 600 i banorëve, përafërsisht me 20 nxënës nga klasa I deri në klasën VIII, për shkak se arsimi është tillë, sistemi tetëvjeçar.

Për të mbrojtur atë pjesë atje, ata kërkojnë edhe për çështjen e diplomave që ne më herët e kemi pasur një organ i themeluar Spark, për njohjen e diplomave anasjelltas, ai ka dështuar, tani ka mbetur si proces i marrëveshjeve të Brukselit për zgjidhjen e kësaj çështjeje që nuk është zgjidhur ende.

Ata kanë probleme sepse nuk pranohen mësuesit që e kryejnë nëpër universitetet tona dhe të shkojnë atje të japin mësim, me ato që kanë mundësi.

Po të njëjta kërkesa kanë qenë edhe në Bujanoc, Këshilli ka kërkuar ato kërkesa që i lexoi edhe Ismajli. Pajisjen me dokumente të qytetarëve të Luginës me dokumente të shtetësisë në Kosovë.

Ata e kanë mundësinë e liberalizimit, ata e kanë mundësinë e lëvizjes së lirë, ata kanë mundësi të shkojnë nëpër Evropë, ata rrinë aty, qëndrojnë në vendin e gjyshërve e stërgjyshërve.

Ata kërkojnë që banorët të cilët janë shpërngulur ose familjarët e tyre që janë në Kosovë të pajisen me dokumente, sepse ka vjet që janë bërë gati 20 vjet po bëhen që ata nuk kanë dokumente, domethënë një dokument i shtetësisë të paktën t’u mundësohet lëvizja dhe regjistrim apo edhe pjesëmarrja në votime.

Çështja e mbështetjes së kulturës, rinisë dhe sportit ka qenë një nga kërkesat që ata e kanë prezantuar.

Prezantimi i tyre është që Ministria e Kulturës ka bërë disa marrëveshje atje të bashkëpunimit. Të gjitha ato marrëveshjet si memorandum bashkëpunimi në investime të realizohen. Nja dy projekte ata i kanë realizuar, një ishte në shkollën “Naim Frashëri”, një tjetër në një shkollë tjetër.

Qeveria e Kosovës kishte bërë një përpjekje, Parku i Paqes, po ashtu ta ndërtojë, të investojë atje. Po gjithat janë investime shumë të pakta, të cilët nuk e mbrojnë interesin kombëtar në Luginë. Prandaj, ata kanë kërkuar që të ketë mundësi në programe ose investime në media, në kulturë që ata të paktën të jenë pjesë e mbrojtjes, kulturës dhe traditës atje.

Kërkesë e tyre është që të investohet me projekte, e këto projekte ka mundësi Qeveria t’i bëjë. Po atë kishim vështirësi ishte çështja e transferimit dhe buxhetit për shkak se drejtpërdrejt transaksionet mes Kosovës dhe Serbisë nuk ishin, atëherë transaksionet shkonin përmes Shqipërisë, Shqipëria përmes Serbisë dhe pagesa bëhej atje.

Kjo ishte një periudhë gjashtëmujore, ishte një lodhje shumë e madhe e pritjes për të gjithë ata banorë ose ato projekte që të realizohen.

Për neve është me rëndësi që fushën e transmetuesit publik të televizionit të Kosovës të kenë një hapësirë ose të kenë një pjesë pikërisht për atë zonë atje që të ndihmohet me programe të veçanta, me programe të kulturës, me programe të arsimit, me programe të edukimit e tjerë, e tjerë, për atë pjesë që edhe ata të jenë pjesë dhe ta ndjejnë veten si në Kosovë.

Prandaj, kërkesat që janë të Këshillit Kombëtar, ata e kanë një vështirësi, për shkak të regjistrimit të 2011-tës, mospjesëmarrja në regjistrim ata i kanë zvogëluar si numër nga 29 në 15 anëtarë, që do të thotë që ata janë zvogëluar mjaft shumë edhe tash buxheti i Serbisë për pakicat është shumë i vogël në raport me numrin që nuk kanë dalë, duke respektuar kërkesat që janë bërë nga Prishtina për dalje apo mosdalje nëpër zgjedhje.

Atë që e kemi parë që është më e rënda prej të gjitha të rëndave është që ata janë mjaft të përçarë, të gjitha partitë njëra-tjetrën dhe kërkesat e tyre janë shumë inatçore, takimet me njërën ose me tjetrën po ashtu.

Megjithatë, unë nga ajo që e shoh, kërkoj që pikërisht nga institucionet e shtetit, nga Kuvendi, nga të gjithë të kërkohet që ata të paktën të unifikohen dhe të mbrojnë kërkesa e qëndrime të përbashkëta, pikërisht për mbrojtjen e interesit të përbashkët të qenies kombëtare në atë pjesë.

Tjetër, kërkesë e tyre është po ashtu që të jenë pjesë e një dialogu në raport me Serbinë. Këto janë çështje politike, për mua ndoshta të arsyeshme, edhe të atyre, por megjithatë mendoj që një raport i tillë është shumë i vështirë të realizohet, por megjithatë si kërkesë e tyre është mirë të shqyrtohet.

Çështje për të cilën duhet të bisedohet është respektimi i reciprocitetit.

Aq të drejta sa kanë serbët në Kosovë, me përqindje të numrit të banorëve, po ashtu t'i jepet mundësia të kenë të drejtat shqiptarët në Luginën e Preshevës, Medvegjë, Bujanoc, po edhe në Vranjë e tjerë, e tjerë ku janë.

Prandaj, numri real i shqiptarëve nuk është i prezantuar asnjëherë, numri real i tyre aq sa ka në pjesën e Luginës, ka edhe në Beograd, këto i kanë deklaruar atëherë udhëheqësit e Serbisë, veç në Beograd ka qenë një deklaratë e asaj Qeverie para luftës që jetojnë mbi 82 mijë shqiptarë, këtë e ka pas thënë presidenti i përbashkët Bullatoviç në atë kohë, e tash ata nuk kanë asnjë të drejtë, asnjë mundësi të mësimi.

Ka qenë dikur një shkollë, "Liria", në Beograd, ajo nuk ekziston, ka qenë një shtëpi e kulturës apo një institut, edhe ato nuk janë. Prandaj, forma e reciprocitetit është forma më e mirë e mbrojtjes së identitetit dhe kulturës tonë dhe njerëzve tanë dhe asaj pjese si territor, edhe si gjuhë, si arsim, si politikë dhe si shtetësi.

Prandaj, unë kërkoj që këto rekomandime që janë bërë, t'i votojmë, nëse ka mundësi ose ka kërkesa për plotësim-ndryshim, jemi të gatshëm t'i plotësojmë e t'i ndryshojmë dhe t'i dalim në ndihmë atyre njerëzve atje, asaj shoqërie, asaj popullsie tonë në Luginën e Preshevës.

Janë kërkesa të Këshillit Kombëtar Shqiptar atje që ne i mbështesim në realizimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hasani! Personin që e përmende më herët tani më është i ndjeri, ka vdekur dje, Bulatoviçi, ai presidenti, ka vdekur dje.

Arban Abrashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ARBAN BRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Javë më parë, së bashku me 5 deputetë të tjerë, kolegë të Komisionit për Arsim dhe Komisionit për Administratë, vizitua Tupallën, Banjën e Siarinës, Tërnovcin, Medvegjën, Bujanocin e Preshevën, ndalua edhe në Vranjë që të informohemi, më mirë, më shumë, nga dora e parë për gjendjen atje.

Gjendja atje, perspektiva në zbehje, një e ardhme e zyrtë që po projektohet, bën që ne sot si Kuvend, si komisione të reagojmë, të sensibilizojmë edhe më tej çështjen, si dhe të gjejmë bashkërisht zgjidhje për problemet e shqiptareve në Luginën e Preshevës.

Të flasësh pas vizitës është mjaft e vështirë dhe e rëndë. Sepse po flasim për një vend, një hapësirë, ku mbizotëron një situatë e pashpresë, ku qytetaret kanë kufizime në të jetuar e vepruar, me mungesa të theksuara në segmentin edukativo-arsimor, progresin ekonomik e zhvillimor dhe të mirëqenies, nën presionin e përditshëm sistematik e të projektuar për largim nga shtëpitë e tyre. Ne vizituam shkollat, institucionet lokale, përfaqësues të shqiptarëve, mediat e bizneset, si dhe ndaluar tek disa familje.

Aty u njoftuam me situatën dhe gjendjen e rëndë në arsim në përgjithësi, sikurse edhe vështirësitë sa i përket furnizimit me tekste mësimore, nostrifikimin e diplomave, implementimit të marrëveshjeve për sa i përket njohjes së diplomave, mungesës së kabinetëve, gjendjes së infrastrukturës në këto shkolla, e më së keqi, me zvogëlimin e rënien e vazhdueshme të numrit të nxënësve në këto shkolla.

Në Këshillin Kombëtar Shqiptar u njoftuam me situatën e përgjithshme politike, me kërkesat e tyre karshi Kosovës e Shqipërisë, si dhe diskriminimin e vazhdueshëm që ua bënë shtetit serb, posaçërisht në sferën e punësimit të rinjve shqiptarë në institucionet qendrore.

Ne Komunën e Medvegjës, nga 87 punëtorët e administratës, vetëm 3 janë shqiptar, kurse gjendja në institucionet e tjera qendrore, është edhe më e keqe. Spitali rajonal, ku rreth 35 për qind e pacientëve janë shqiptarë, nuk ka të punësuar asnjë shqiptar.

Investimet në infrastrukturë, shëndetësi, mjedis e fusha të tjera janë nën nivelin e mesatares së investimeve në Serbi.

Sot komunat e banuara me shqiptarë janë dukshëm më të pazhvilluara, që vërtetohet edhe me statistikat e vet shtetit serb, prandaj po flasim për një politikë të organizuar dhe formuar në atë mënyrë që në komunat që banojnë me shqiptarë, por edhe komunat e tjera me popullatë joserbe, të mos investohet, në mënyrë që perspektiva e këtyre banorëve të zbehet dhe errësohet vazhdimisht, dhe të motivohet migrimi.

Sot në shkollën e Tupallës vijojnë mësimin 7 nxënës, kurse me nxënësit e Kapitit e Gjylekreshtes ky numër arrin vetëm 16, pas ndonjë viti edhe këto shkolla rrezikojnë të mbyllën, këta njerëz po shohin kah Kosova, përkatësisht Prishtina e Fushë-Kosova për të ndërtuar ardhmërinë e tyre.

Fatkeqësisht, arsimit nuk është problem i tyre i vetëm, ata ballafaqohen edhe me shumë probleme të tjera. Diskriminimi sistematik në çdo sferë, i vendbanimeve me popullsi shqiptare, në Medvegjë, Malësinë e Bujanocit, e Karadak të Preshevës.

Ky diskriminim programor e sistematik rrezikon ndryshimin e përbërjes etnike të popullsisë si plan afatgjatë, kurse si veprim me efekt të menjëhershëm, ky diskriminim ka shpërfaqur rezultate negative, edhe në proceset e fundit zgjedhore, ku shumë qytetarë të Luginës së Preshevës nuk kanë mund të ushtrojnë të drejtat e tyre për të zgjedhur dhe për të qenë të zgjedhur.

Sfida të tjera ka edhe në fusha të tjera. Mungesa e aktiviteteve kulturore për shkak të mospërkrahjes së nevojshme financiare. Një praktikë e keqe e ushtruar në mënyrë sistematike është edhe shpërndarja e ftesave për biseda informative me qëllim të frikësimit të qytetarëve të krijimit në një gjendje të pasigurisë.

E përpos këtyre problemeve, edhe ato marrëveshje të arritura në ndërkohë e të zotuar për implementim mbasin vetëm në letër.

Mosimplementimi i marrëveshjes të vitit 2001, si Marrëveshja e Konçulit, marrëveshja e vitit 2009, si Marrëveshja për ristrukturimin e trupit koordinues dhe Marrëveshja e vitit 2013 si masat urgjente apo Plani 7-pikësh.

Të nderuar deputetë,

Edhe sot këtu duhet të nisim hapat e parë konkretë në përmbysjen e kësaj situatë, për të kthyer shpresën, perspektivën, duke ofruar siguri e përkrahje për ata banorë të mbetur dhe jo vetëm për të menduar, po edhe për të reaguuar me veprime e me masa konkrete afatshkurtra dhe afatgjata dhe këtë nismë ne duhet ta fillojmë sot këtu, në Kuvend, duke kërkuar nga ekzekutivi t'i përmbushë obligimet, sikurse t'i tejkalojë ato duke ndërmarrë nisma të reja sistematike, duke mbështetur një plan konkret që tejkalon mandatet qeveritare dhe politikat ditore. Ne sot duhet të krijojmë programe, mekanizma e projekte konkrete, sikurse plane afatgjate me njerëz përgjegjës për realizimin e tyre në funksion të përmirësimit të jetës së shqiptarëve në Luginë të Preshevës, si dhe në ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar. Shtypja dhe diskriminimi, edhe pse i ka lodhur ata qytetarë, ka një domethënie, ata ende vazhdojnë të luftojnë për të drejtat e tyre dhe ne duhet t'u ndihmojmë, duhet të ndjejmë, të shohim, përjetojmë, me ndihmën dhe mbështetjen tonë financiare politike dhe diplomatike. Është vërtet fatkeqësi që sot në vitin 2019 në Evropë, në këtë pjesë të Ballkanit dhe të Serbisë, të një shteti që aspiron të jetë pjesë e BE-së, shqiptarët e Luginës jetojnë në gjendje të paperspektivës totale të diskriminimit etnik, kulturor dhe social.

Ata edhe sot luftojnë për të drejtat e tyre bazike elementare, për tekste shkollore, për mundësitë e nostrifikimit të diplomave dhe për përdorimin e simboleve kombëtare, simbole këto të përdorura edhe gjatë kohës së monizmit. Sot Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet përkatëse, deri

tek Akademia, duhet të mobilizohen për hartim të një plani afatshkurtër dhe afatmesëm për Luginën e Preshevës, një plan dhe shumë pika, me fonde dhe ekipe permanente që merren me këtë çështje. Lugina dhe qytetarët tanë atje s'guxojnë të jenë monedhë kusuritje në dorë të askujt, as për politikanët populistë serbë, as politikanëve populistë kosovarë, as atyre të Shqipërisë, as atyre të bashkësisë ndërkombëtare.

Në kuadër të bisedimeve me Serbinë, ne duhet t'u ofrojmë SHBA-së, BE-së dhe Beogradit garën e hapur të mendësisë evropiane, platformën për diskriminim të njëjtë pozitiv ekuivalent, aq sa ka të drejta ligjore kushtetuese për komunitetet në Kosovë, aq duhet të ketë të drejta edhe për shqiptarët në Luginën e Preshevës. Integritet e përshpejtuara evropiane në gjithë rajonin, mobilizimi dhe fokusimi në këto integritete ndihmon shqiptarët në Luginë, faktorizon ata dhe i largon politikat tradicionale serbe. LDK-ja do të mbështesë çfarëdo rezolute, projekti apo ndarje të fondeve që ne sot si Kuvend i Kosovës dakordohemi dhe zotohemi që t'i realizojmë, përpos ndarjes së fondeve dhe projekteve të tjera konkrete, ne synojmë dhe propozojmë që Lugina e Preshevës, përmes Këshillit kombëtar shqiptar të hapë zyrat e tyre ndërlidhëse apo lobuese në qytete të ndryshme, duke përfshirë edhe Brukselin, Beogradin, Prishtinën e Tiranën, në mënyrë që të koordinojë dhe të ketë komunikim të përhershëm politik, diplomatik dhe kulturor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Veç desha të njoftoj që fjala e zotit Hasani si deputet i PDK-së ishte edhe fjalë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, Sami Kurtoshi është i pari apo Albin Kurti në emër të Grupit Parlamentar.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës!

Deputetë të Kuvendit,

Zgjidhja e çështjes së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit nuk është vetëm çështje e sigurisë. Ajo, në radhë të parë, paraqet çështje të drejtave individuale dhe kolektive të shqiptarëve, por është edhe kriter i integriteteve evropiane të Serbisë. Pa ndryshuar rrënjësisht gjendja e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, nuk është e mundur që Serbia të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Kapitujt 23 dhe 24, Gjyqësori, të Drejtat dhe Liritë Themelore, Siguria, e imponojnë këtë gjë. Mirëpo, në vend se ne t'i përdorim këta dy kapituj për të përmirësuar pozitën e shqiptarëve atje, nga Prishtina është demobilizuar Lugina e Preshevës pikërisht në emër të premtimit që ata shumë shpejt do të na bashkëngjiten neve pa ndonjë farë sforcimi shtesë, paçka se më herët ishte zhvilluar një luftë, bartëse e së cilës ishte Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, dhe gjithashtu ishte mbajtur edhe referendumi i 1 dhe 2 marsit të vitit

1992, i cili referendum nuk është përfshirë në pozicionet zyrtare as të shtetit të Kosovës, e as të Shqipërisë.

Për shkak të bojkotimit të regjistrimit të popullsisë, siç ka vërejtur Këshilli për të Drejtat e Njeriut, është reduktuar edhe numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar Shqiptar nga 29 në 15, për shkak se Ministria për Administratë Shtetërore dhe Vetadministrim Lokal e ka aplikuar kriterin, sipas të cilit në Serbi ka gjithsej vetëm 5.805 shqiptarë. Ky është një qëndrim cinik i shtetit serb. Kur është bojkotuar regjistrimi i popullsisë atje, ata pak që janë regjistruar, janë konsideruar të vetmit shqiptarë që ekzistojnë atje. Prandaj, edhe duke e zvogëluar Këshillin Kombëtar Shqiptar nga 29 në 15 anëtarë, kjo ka rezultuar edhe në zvogëlimin e mjeteve financiare që këtij Këshilli i ndahen nga buxheti.

Papunësia në krahinën shqiptare që ka mbetur nën administrimin e Serbisë është shumë e madhe, gjë që shkakton emigrim drejt Kosovës dhe shteteve perëndimore. Vetëm në periudhën mes viteve 2012-2016, numri i nxënësve në Preshevë ka rënë për 1.300. Nga komuna e Medvegjes, pas vitit 1999, janë shpërngulur 5.500 shqiptarë, apo mbi dy të tretat e tyre. Në shkollën e fshatit Tupallë, ku dikur mësimet i vijonin 320 nxënës shqiptarë, kanë mbetur vetëm 15 nxënës. Në fshatrat e komunës së Bujanocit, si Zarbinca, Suharna, Novosella e Epërme, Priboci, Muhoci, Ramabuça, Gjergjeci e Çarri, që njihen edhe si fshatrat e Malësisë së Bujanocit, e ku dikur jetonin mbi 10 000 banorë, kanë mbetur vetëm 16 familje. Në vitin shkollor 1981/82 shkolla fillore "Skënderbeu" në Zarbincë numëronte 851 nxënës, kurse në vitin 2018 kjo shkollë ka ngelur vetëm me 8 nxënës.

Ata që janë zhvendosur në Kosovë, nuk janë evidentuar as si kategori e të dëbuarve të luftës, as si refugjatë, as si persona të zhvendosur brenda shtetit dhe, ende nuk kanë dokumentacion të rregulluar me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm. Serbia vazhdon diskriminimin e kësaj krahine që banohet me shumicë shqiptare dhe i evidenton si qytetarë 'juridikisht të padukshëm'. Ndaj tyre zbatohet mosvazhdimi i dokumenteve, pasivizimi i adresave dhe i vendbanimit, verifikimi i fakteve të qëndrimit të përhershëm në mënyrë selektive, dhe kështu ata gradualisht i humbin të drejtat sociale dhe ato të votuesit, siç thuhet në raportin e Këshillit për Drejtat e Njeriut.

Kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka deklaruar se përfaqësimi i shqiptarëve në gjyqësorin lokal është joproportional. Për shembull, në Preshevë vetëm 5% të popullsisë janë serbë, mirëpo ata përfaqësohen me 60% në gjyqësorin lokal. Shkalla e papunësisë tejkalon 60%, ndërsa këto komuna i kanë të hyrat më të vogla për kokë banori, krahasuar me pjesët e tjera të Serbisë. Presheva, Medvegja dhe Bujanoci paraqesin rajonin më të pazhvilluar në Serbi. Presheva, për shembull, komunë me mbi 90% shqiptarë, është komuna më e pazhvilluar me vetëm 200 euro për kokë banori, me shkallë rekorde të papunësisë e parametra të ngjashëm vlejné edhe për Bujanocin e Medvegjën. Sipas të dhënave të Odës Ekonomike në Leskoc, paga

mesatare mujore në Qarkun e Pčinjës dhe Jabllanicës në tetor të vitit 2015 ishte për 24% më e ulët se paga mesatare në Serbi. Papunësia ndër shqiptarët, sipas raportit të KDNJ-s, është më e larta në rajon pas asaj të popullsisë rome.

Për sa i përket shkrimit, problem të veçantë paraqet fakti se emrat në gjuhën e pakicave, të cilat përmbajnë shkronja që nuk ekzistojnë në shkrimin cirilik, deformohen me rastin e transkriptimit. Një gjë e tillë paraqet problem sidomos për personat të cilët nuk kanë mundësi të marrin dokumente në gjuhën amtare. Rezoluta e Parlamentit Evropian për Standardet Minimale për Pakicat e inkurajon komisionin dhe shtetet anëtare të pranojnë se secili person që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtë ta përdorë mbiemrin e saj ose të tij (patronimin) dhe emrin në gjuhën e pakicave, dhe ka të drejtë në njohjen e tyre zyrtare (emrit dhe mbiemrit), përfshirë edhe në kontekstin e lirisë së lëvizjes brenda Bashkimit Evropian. Kjo rezolutë është miratuar më 13 nëntor të vitit 2018. Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave Kombëtare pamundëson përdorimin e simbolit të shqiptarëve, flamurit me sfond të kuq dhe me shqiponjën e zezë dykrenare në mes. Në aq shumë aspekte shqiptarët atje e kanë gjendjen shumë më të rëndë edhe se në kohën e Jugosllavisë famëkeqe.

Pas kërkesave të shumta për disa vjet, materniteti më në fund është hapur në prill të vitit 2015. Me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë është lejuar që për nevojat e punës të pranohen dy mjekë specialistë dhe 10 infermiere. Materniteti është ndihmuar edhe nga Qeveritë e Kosovës dhe Shqipërisë, por me nga 50.000 euro. Kaq i kemi ndihmuar ne shqiptarët atje, që të mund të lindin, por jo edhe që të mund të rriten dhe të jetojnë. Vështirësitë e lindjes mbase nënave shqiptare atje ua kemi lehtësuar, mirëpo jo edhe vështirësitë e rritjes së fëmijëve të tyre, të cilët kur rriten, masivisht emigrojnë. Barnatorja në Preshevë është pjesë e barnatores në Vranjë. Diskriminimi, nënpërfaqësimi, shfrytëzimi, shtypja e shqiptarëve atje është e pashembullt. Ndërkaq, premtimi që ata do të na bashkohen neve me konferenca shtypi që organizon presidenti, vetëm sa i kanë demobilizuar dhe i kanë pasivizuar. Natyrisht që ne mund t'i rendisim shumë hapa, aksione që duhet t'i ndërmarrim për shqiptarët atje, por unë do t'i kisha përmbledhur në katër kryesore.

Institucionet e Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe ato të Shqipërisë, duhet të kërkojnë:

- 1) Televizion publik në gjuhën shqipe në Preshevë,
- 2) Universitet në gjuhën shqipe në Bujanoc,
- 3) Investime të shqiptarëve në Medvegjë dhe,
- 4) Heqjen e bazës ushtarake të Serbisë në Boroc të Bujanocit.

Në këtë mënyrë, me këto kërkesa, shqiptarët kudo që janë, jo vetëm në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, dhe jo vetëm institucionet e Kosovës e të Shqipërisë, dalin në ofensivë kundrejt shtetit të Serbisë, i cili nuk ka as keqardhje e pendesë për krimet nga e kaluara dhe as që i ka ndryshuar qëllimet e planet për neve për të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kështu, ka shumë diskutues, grupet parlamentare, përkatësisht përfaqësuesit e grupeve parlamentare, po Ismajl e mora vesh, do t'ua jap fjalën të gjithëve, por vetëm me mirëkuptim.

Zoti Kurteshi si propozues vetëm një herë, pastaj vazhdojmë te grupet parlamentare.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Në konsultim edhe me përfaqësuesit e grupeve jemi marrë vesh që ta formojmë një grup që përfaqësojnë të gjitha grupet dhe të dalim dhe t'i harmonizojmë konkluzionet, në mënyrë që në fund të debatit të dalim edhe me konkluzione të harmonizuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! është për mirëmbajtjen e seancës, zonja Haxhiu fjala është për ju më duket, se po e shoh, në emër të AAK-së, por unë fjalën s'do t'ia ndal askujt, po janë bërë 20 e sa deputetë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Vetëm se duhet ta respektojmë Rregulloren.

Faleminderit, kryetar!

Grupet parlamentare flasin në emër të grupeve edhe askush s'ka të drejtë të flasë në emër të dikujt tjetër. Secili grup parlamentar e ka përfaqësuesin e vet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë, mbi të gjitha qytetarët e Luginës së Preshevës, të cilët i kanë brengat e njëjta dhe shumë pak janë, besoj, të interesuar të na shohin neve këtu, të flasim për histori ndër vite, e ndoshta dikujt prej neve iu ka ndalur memoria aty, duke parë edhe që atje ka ndryshuar edhe kryetarët e komunave, janë të tjerë, domethënë nuk janë të njëjtit, pra janë ish-kryetarë. Megjithatë, po problemet janë të njëjta. Për të mos folur shumë, ata jetojnë me brengat e tyre dhe njëkohësisht i dinë gjithë mbështetjen që ka mundur cilado prej qeverive për ta bërë për Luginën, e në fakt nuk është bërë kurrë aq sa është kërkuar dhe cilat janë mundësitë ne sot duhet të diskutojmë, ajo që mua më bie në sy është keq, ndoshta pikërisht seanca nuk po e tregon atë që ne kemi synuar, nuk e kemi prezencën e ministrave që do duhej ta kishim këtu sot, për të parë pra se cili ministër ka filluar të paktën të bëjë diçka për Luginën e Preshevës dhe të zotohen të gjithë ministrat se çfarë do të bëjnë në të ardhmen, konkretisht.

Pra, nga vizita e 2015-tës dhe nga kjo e fundit që ishim dy komisionet parlamentare, kemi parë problemet e njëjta, por duhet të jemi shumë realë, të mos filozofojmë shumë. Numri i nxënësve është duke rënë skajshmërisht dhe ajo që neve na ka bërë të shqetësuar është pikërisht shkolla e parë, është vizita e parë që të dy radhët i kemi vizituar pra shkollën “Zenel Hajdini” dhe numri i nxënësve bën që pothuajse brenda dy vjetësh të mbyllet komplet ajo shkollë. Fatmirësisht ka biznesmenë shqiptarë që kanë treguar çdoherë që janë në gjendje të sakrifikojnë edhe familjet e tyre, duke udhëtuar me kilometra për të mbajtur shkollën gjallë. Janë njerëz të njohur në atë anë. Mirëpo, ky problem i rënies së numrit të nxënësve është edhe tek ne, por çka ne po bëjmë që ata t’i ndalim për të jetuar aty.

Problemin me libra, me tekste e kemi problem të njëjtë ndër vite, cila është zgjidhja, të mos ndalemi në kohën për të treguar edhe një herë se e dinë të gjithë qytetarët e asaj ane që tekstet kanë mbetur në kufi dhe shteti i Kosovës ka paguar mijëra euro dënim pse kanë qëndruar tekstet në doganë, në fakt nuk kanë rënë në duar të nxënësve dhe ne nuk kemi pasur çka t’u themi më shumë.

Për mua çka është shqetësuese, ata pos që mësojnë, gjenden mësimdhënësit për t’iu mësuar historinë reale të popullit shqiptar, ata tekstet i kanë të papërkthyer, por gjenden vullnetarisht ose në suaza të mundësive të mësimdhënësve për t’iu mësuar, pra arsimin shqip atje. Pos që vazhdon diskriminimi i skajshëm nga shteti serb atje, ne nuk po ia dalim të tregojmë fuqinë tonë si shtet i Republikës së Kosovës që pakicat tona serbe të diskriminuara pozitivisht, krahasuar me secilin komunitet që jeton në Republikën e Kosovës, asnjëherë nuk arritëm ta ngremë zërin fuqishëm te secili faktor ndërkombëtar për të treguar se atje shkelet e drejta më elementare, pra arsimit në gjuhën amtare. Shkelen të drejtat më elementare të përdorimit të simboleve kombëtare, pra thjesht ata e mbajnë arsimin shqip në baza vullnetare. Çka e kemi parë ne pozitive diçka, unë e falënderoj ministrin e Drejtësisë që është këtu, ka realizuar një projekt në një shkollë, ka realizuar edhe ministri i Shëndetësisë, kemi qenë ne aty, unë po flas publikisht për atë që e kemi parë. Është realizua edhe një projekt nga Kryeministri Haradinaj “Parku i Paqes”, ne e kemi vizituar, ende nuk kanë filluar punimet, kemi shkuar me kryetarin e Preshevës, me përfaqësuesit aty, janë disa projekte, sado të janë shumë elementare, por diçka ka lëvizur.

Pse po i përmend këto? Është edhe një projekt, nëse s’gabo, nga Ministria e Arsimit, nëse s’gabo, ministri e thotë, por megjithatë pse po i përmend këto. Është një mbështetje shumë e vogël, por mundësia për të mbështet Republika e Kosovës qytetarët tanë atje është përmes Shqipërisë, shqetësuese ishte ajo që Qeveria përmes këtyre projekteve ka ndarë mjete dhe ato mjete i dedikohen, i shkojnë Shqipërisë, dhe nga Shqipëria në Luginë gjashtë muaj njëri projekt, projekti tjetër një vit. Pra, për ta thjeshtësuar, për ta kuptuar të gjithë qytetarët, mjetet ndahen, por pas një viti i marrin ata, pse të ndodhë kjo? Qysh autoritetet shqiptare, pra nuk e përshpejtojnë procedurën që mjetet t’i marrin, ngase janë dedikuar, pra thjesht ndahet buxheti dhe vonohet një vit, se nuk ka rrugë tjetër. Ajo që për mua është shumë shqetësuese, e kemi

nënkryetarin e Kuvendit këtu, kishte qenë mirë të ishte ministri i Kulturës, pra është diskutuar shumë gjatë një marrëveshje e nënshkruar nga ish-ministri i Kulturës, por edhe nëse s'gaboj, tanimë ministri i Kulturës aktual, marrëveshje e cila asnjëherë nuk po jetësohet. Flasim për shuma parash, por sa ne e kuptuam, ajo që nuk po realizohet është pikërisht ky problemi, pra i dedikimit të mjeteve direkt në Luginë të Preshevës.

Megjithatë, pra, sugjerimet e tyre, kërkesat e tyre të vazhdueshme janë që të jetësohet edhe kjo marrëveshje, por mënyra më e shpejtë, edhe një herë e them, është që secili ministër, secila ministri të realizojë një projekt të madh që për ata do të jetë mjaft. Ministria e Arsimit të ndihmojë jo vetëm në ndërtime të shkollave, në fakt renovime, por edhe në kabinete, pra që t'ua bëjë më të mos them se ata e duan arsimin, ata po vazhdojnë, po thjesht kushte më të mira. Çështja e diplomave është problem i kamotshëm, por ekziston edhe sot e kësaj dite. Pra, ne duhet të kërkojmë, kemi kërkuar edhe me rezoluta të mëparshme të 2015-ës që në bisedimet ndërmjet dy shteteve të Republikës së Kosovës dhe Serbisë të ngrihet në nivelin e duhur çështja e Luginës së Preshevës. Asnjëherë nuk është diskutuar kjo çështje. Tani, ashtu siç di shteti serb me politikën dhelparake, edhe tash e shoh një shqetësim. Ministria e Arsimit atje flitet që do të punojnë në një marrëveshje mirëkuptimi në mes të pakicave, e ndër to, duke përfshirë edhe komunitetin tonë, pra tetë pakica që ekzistojnë në Serbi. Një marrëveshje mirëkuptimi thotë rreth teksteve shkollore. Unë këtë e shoh vetëm blerje kohe, pra për të treguar që Serbia ashtu siç di, pra ka bërë një hap gjoja se “ka bërë një hap para” duke nënshkruar, ende nuk është nënshkruar, por ashtu siç na thanë përfaqësuesit e Këshillit, pra një marrëveshje mirëkuptimi për përkthimin e teksteve dhe përshtatjen e tyre me kurrikulat.

Unë këtë e shoh vetëm blerje kohe, se asgjë nuk do të ndodhë në realitet. Atëherë, qysh mundet shteti ynë të ndihmojë. Krijimi i një fondi, është kërkuar prej tyre pra krijimi i një fondi mbështetës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Luginën, edhe jetësimi dhe realizimi, në fakt, i secilit projekt që ata kërkojnë, me fokus të veçantë të rinisë atje dhe unë kërkoj nga secila ministri që ka kërkesa për projekte të ardhura nga Lugina e Preshevës, të mbështeten këto projekte dhe një gjë që ka ndodhur e mirë, pra ngase ne kemi pasur bashkëpunime shumë të mëdha me shumë përfaqësues atje, siç është edhe kryetari i Shoqatës “Trojet” që po realizohet, pra çështja e lejeqëndrimit, tanimë është dashur ministri të tregojë që është realizuar, por kërkesa e tyre pra e vazhdueshme dhe përpjekjet e tyre të vazhdueshme kanë bërë që kjo të realizohet. Po realizohet pra lejeqëndrimi dhe shtetësia pas 5 vjetësh. Faleminderit!

KRYETARI: Dukagjin Gorani, në emër të Partisë Socialdemokrate.

DUKAGJIN GORANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Besoje që sot jemi mbledhur që ta propozojmë ndonjë veprim, e jo vetëm të japim mendim e të shprehim qëndrim. Situata e shqiptarëve në Luginë të Preshevës nuk ka ndryshuar për të mirë

prej rezolutës së këtij Kuvendi në qershorin 2013, prej premtimit të Fondit të përbashkët nga viti 2014, e deri te garancitë elektorale për dhënie të nënshtetësisë së Kosovës nga viti 2017.

Shqiptarët e Luginës vazhdojnë të jetojnë në mes premtimeve të papërbushura nga Republika e Kosovës dhe mospërfilljes sistematike nga Republika e Serbisë. Atje ata reduktohen në individë, edhe pse janë komunitet. Kurse, këtu për ta flasim si komunitet, e nuk ua mundësojmë statusin e shtetasit, të qytetarit e as të individit. Jeta në përkohshmëri, në pritje e në paqartësi, ata i detyron në mërgim dhe braktisje. Këto ditë fati dhe ardhmëria e tyre është reduktuar në një monedhë kusurimi gjatë hamendësimeve amatore mbi shkëmbime të territoreve dhe demarkacione etnike. Ashtu qysh e kemi dëshmuar edhe më herët gjatë viteve, Kosova dhe ky Kuvend nuk mund të bëjnë shumë për shqiptarët në Republikën e Serbisë, mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk do të bëjnë asgjë.

Ndryshe prej Qeverive të kaluara, kjo e sotmja së paku do të duhej të hapë një zyrë për Luginën e Preshevës në kuadër të Kryeministrit. Do të ishte ky një veprim i vogël e simbolik, mirëpo do ta vendoste një adresë të përhershme për banorët e Luginës. Do të ishte pikënisje e mirë për ta kërkuar zbatimin e premtimeve tona dhe për ta nisur një bashkëpunim kuptimplotë.

Patjetër do të ishte avancim i mëtutjeshme në vazhdë të përpjekjeve të mira të Qeverisë aktuale, çfarë ishte ndarja e 112 000 eurove për Komunën e Preshevës dhe çfarë ishte hapja e shkollës filllore në Samolicë të Bujanocit një muaj më herët.

Për Partinë Socialdemokrate hapja dhe funksionimi i Zyrës së Luginës së Preshevës në Qeverinë e Republikës së Kosovës do të ishte hapi i parë dhe i domosdoshëm që do të mundësonte: hartimin e një plani gjithëpërfshirës shtetëror për Luginën dhe banorët e saj; hapjen e një linje të veçantë buxhetore për të dhe mbështetjen shtetërore e buxhetore për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi.

Asistenca e Kosovës për këtë organ është me rëndësi të madhe, veçanërisht pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për financimin e këtij Këshilli, vendim i marrë me 30 maj të këtij viti.

PSD konsideron se marrja e këtyre vendimeve e veprimeve është e domosdoshme. Komuniteti shqiptar vazhdon të trajtohet si i paqenë nga qeveritë e Serbisë, përkundër tri marrëveshjeve të nënshkruara me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, përkundër Marrëveshjes së vitit 2001 të njohur si Plan i Çoviqit, e pranuar dhe e nënshkruar në kuadër të Marrëveshjes së Konçulit, përkundër Marrëveshjes së vitit 2009 për riorganizimin e Trupit koordinues, asokohe e kuptuar si organ qeveritar për Luginën, e që parashihte integrimin e dhjetëra shqiptarëve nëpër institucione shtetërore, si Doganat e Administrata Tatimore dhe përkundër Planit shtatëpikësh, të emërtuar kështu si ilustrim i përkushtimit shtetëror të Serbisë për të avancuar pozitën e

shqiptarëve të Luginës, në shtatë fushat kryesore të jetesës, prej punësimit e deri te statusi politik e shoqëror.

Deri në këtë ditë Qeveria e Serbisë nuk e ka kryer as edhe një nga obligimet e pranuar dhe të nënshkruara çfarë ishin. Integrimi i shqiptarëve të Luginës në shërbimin e vet publik e shtetëror, kjo në një masë të papërfillshme është e mundur vetëm në nivelin komunal, aty ku edhe ashtu udhëheqin shqiptarët. Qeveria e Republikës së Serbisë refuzon ta urdhërojë largimin e njësive speciale ushtarako-policore nga Lugina. Pa ndërprerje, stacionimi i këtyre forcave vazhdon që nga periudha e konfliktit në vitin 2000. Ajo vazhdon ta pengojë kthimin e shqiptarëve të dëbuar dhe të shpërngulur. Tash e mbi 20 vjet qindra shqiptarë nga Lugina e Preshevës mbeten persona pa shtetësi, pa status, pa shtëpi dhe pa vendlindje.

Në përpjekjet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian Republika e Serbisë nuk kushtëzohet me avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Në raportin e fundit të progresit përmendet vetëm problematika e mosintegritit të tyre, duke e definuar këtë si çështje dytësore dhe kalimtare. Me këso qasje ka shumë gjasa që Beogradi t'i përmbyllë me lehtësi kapitujt 23 dhe 24 në bisedimet për anëtarësim në BE.

Të nderuar deputetë dhe Kabinet qeveritar,
Sytë e shqiptarëve të Luginës vazhdojnë të mbesin të drejtuar kah ne. Sot duhet të jemi të gatshëm t'ua dëshmojmë se nëse nuk mund të bëjmë gjithçka për brengat e tyre, së paku mund të bëjmë diçka, diçka që do të jetë vendim e veprim, e jo vetëm premtim. Le t'ia fillojmë me hapjen e Zyrës së Luginës pranë Kryeministrit. Le të jetë kjo një derë, një adresë dhe një prani e përditshme e halleve të tyre në jetën tonë. Ajo duhet të hapet si shenjë e vullnetit të sotëm, që të mund të shndërrohet në obligim të nesërm për mirëkuptim, përkushtim dhe bashkim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj-Halimaj, në emër të Nismës Socialdemokrate.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Nisma ka qenë prej fillimit pro këtij debati për Luginën e Preshevës dhe aty kur u tha që një debat i tillë nuk është mirë të jetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se deputetët mund të tregojnë një populizëm. Përkundrazi, ne e mbështetëm dhe sigurisht edhe i dhamë nënshkrimet për këtë seancë. Më e pakta që ne deputetët mund të bëjmë për qytetarët dhe Luginën tonë atje.

Po filloj me regjistrimin e popullsisë, kur është bërë në vitin 2011, që shqiptarët në Luginën e Preshevës e kanë bojkotuar. Nga 61 000 sa ka pasur në vitin 2002, kur janë regjistruar, në vitin 2011 kanë qenë ose janë regjistruar vetëm 5 800. Ky regjistrim ka bërë që Këshilli Kombëtar Shqiptar pastaj në Luginë të zvogëlohet nga 29 anëtarë në vetëm 15. Pastaj, sigurisht se edhe buxheti është zvogëluar. Do të ishte mirë që Bashkimi Evropian të merrej që nga 2011-ta seriozisht me bojkotimin e shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe këtë regjistrim në Serbi të mos e njihete si regjistrim.

Ajo që e tha kolegu deputet pak më parë për zyrën, e kisha idenë e njëjtë edhe unë, por për të dalë përtej kësaj, për të dalë përtej zyrës që është tepër e nevojshme në Luginën e Preshevës, pra një zyrë e Kosovës atje, e Qeverisë, do të duhej dhe unë do të propozoj që përveç kësaj, të kemi këtu në Kosovë edhe një ministri për Luginën e Preshevës. Pse jo, kur jemi në gjendje të kemi 21, 22, 24 ministri, madje ministri të cilat ndoshta nuk do të ishin të nevojshme, pse të mos e kemi edhe një ministri të veçantë për Luginën e Preshevës, përveç zyrës, e cila besoj që shumë shpejt Qeveria e Kosovës do ta realizojë.

Bashkimi Evropian do të duhej që përveç që neve siç na tërheqin vërejtjen për mosrealizimin e disa marrëveshjeve që janë bërë në 2013-ën në Bruksel, e që ne jemi shumë më të disiplinuar krahasuar me Serbinë, të merret edhe me Serbinë, që edhe ata t'i respektojnë marrëveshjet e nënshkuara nga 2013-ta në Bruksel. Ajo që është tepër e rëndësishme, në Luginë atje është që Serbia nuk i njej diplomat tona. Tanimë Ministria e Arsimit nga sa ka qenë 3% kuota për studentë të Luginës dhe Malit të Zi, tani vetëm Lugina i ka 2% kuota dhe megjithatë, edhe pse ata studentë e kryejnë këtu fakultetin, atyre atje nuk u njihen diplomat. Prandaj, e kemi një gjendje të tillë në administratë atje, ku fare pak shqiptarë punojnë, sepse edhe ata që përfundojnë studimet këtu, nuk kanë të drejtë të punojnë në Luginë.

Si ka mundësi që deri më tani nuk ka ekzistuar një linjë buxhetore nga Republika e Kosovës për Luginën e Preshevës? Nëse deri më tash nuk ka ekzistuar, unë besoj dhe Nisma beson se tani e tutje do të mundohemi që ta kemi një linjë buxhetore, përveç Kosovës, besoj se edhe Shqipëria do të pajtohej me këtë, sepse Kosova dhe Shqipëria së bashku të dyja kanë rreth 7 – 8 miliardë euro buxhet dhe të mos jenë në gjendje ta kenë një linjë të veçantë për Luginën e Preshevës është e tmerrshme. Dhe imagjinoni çka kanë kërkuar ata, imagjinoni. Kanë kërkuar t'i mbështesim mediet lokale në Luginë dhe këtë të mos jemi në gjendje t'ua mundësojmë është... është tepër... është tepër të rrimë këtu. Prandaj, besoj që ky debat të mos mbetet një debat që kalon, por që këto rekomandime që do t'i japim do të realizohen, nëse nuk ekzistojnë mundësitë ligjore që Kosova ta ndihmojë Luginën drejtpërsëdrejti, atëherë ne e kemi Shqipërinë që nëpërmjet Shqipërisë, po edhe Shqipëria vetë, ta ndihmojmë Luginën në forma të ndryshme.

Janë edhe tekstet shkollore që ata i kanë ngritur si shqetësim. Ka vite e vite që tekstet shkollore ata mësojnë me plan-program të Serbisë, ndërkohë që në Kosovë serbët mësojnë me plan-

program të Serbisë dhe jo të Kosovës. Si ka mundësi që Lugina, ose Luginës të mos i mundësohet të mësojnë në gjuhën amtare, ndërsa atyre këtu po. Prandaj, Bashkimi Evropian do të duhej të merrte masa edhe në këtë çështje.

Ne do t'i japim rekomandimet tona tani kur të mblidhemi grupet parlamentare dhe besoj e uroj që këto rekomandime të realizohen sa më shpejt që është e mundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Albert Kinolli, në emër të 6+-it.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar 6+ t'i them disa fjalë rreth situatës aktuale të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Fillimisht dëshiroj t'i përshëndes kolegët e mi nga dy komisionet parlamentare, atë për Medie dhe Komisionin për Arsim, të cilët javë më parë vizituan Luginën e Preshevës dhe në takimin e përbashkët që patëm dy komisionet parlamentare gjerësisht na njoftuan për situatën aktuale që ndodhet në Luginë, edhe pse për ne nuk ka qenë diçka e re.

Më 1 dhe 2 mars të vitit 1992 rreth 97% të 45 000 votuesve shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në 71 vendbanime u deklaruan për autonomi politiko-territoriale me të drejtë bashkimi i Kosovës. Rreth 100 000 shqiptarë etnikë të Luginës së Preshevës për herë të parë gjatë historisë patën rastin që në mënyrë të organizuar dhe dinjitoze ta shprehin vullnetin politik përmes referendumit, duke votuar demokracinë, vetëvendosjen dhe ardhmërinë e fëmijëve të tyre. Por, fatkeqësisht kaluan 27 vjet nga mbajtja e referendumit, e statusi politik i shqiptarëve të këtij rajoni mbetet i pandryshuar.

Pushteti i dikurshëm dhe ai aktual i Serbisë nuk i përmbushën kërkesat legjitime të shqiptarëve që edhe vetë i vënë në planin për zgjidhjen e krizës në hapësirat e Luginës së Preshevës. Gjendja e shqiptarëve të Luginës edhe pas 27 vjetëve të referendumit mbetet e brishtë dhe me probleme politike dhe ekonomike. Në këtë drejtim nuk është zgjidhur akoma me ligj përdorimi i simboleve kombëtare, nuk është zbatuar në praktikë dygjuhësia, mungesa e njohjes së diplomave, e tjera. Edhe më tej vazhdon të jetë situata aktuale jashtëzakonisht shqetësuese sa i përket edhe migrimit të popullatës në Perëndim, për shkak të varfërisë ekstreme dhe papunësisë. Vazhdon të jetë jo i kënaqshëm integrimi i shqiptarëve në organet shtetërore dhe institucionet publike. Prandaj, është e domosdoshme të sigurohet qasje shumë më serioze e institucioneve të Kosovës në zgjidhjen e problemeve shumë të ndjeshme që hasin shqiptarët e Luginës. Institucionet e Kosovës, por edhe subjektet politike, si dhe aktorët e tjerë duhet të angazhohen maksimalisht në përkrahjen e

shqiptarëve të Luginës, të krijohen politika shtetërore për të siguruar ndihmën për këtë popullatë, e cila seriozisht ballafaqohet me probleme të mëdha, duke filluar nga arsimimi e deri te kushtet ekonomike, e në përgjithësi me mosgëzimin e të drejtave të tyre.

Për fund, ne si grup parlamentar 6+ përkrahim dhe mbështesim plotësisht rekomandimet të cilat i theksoi më herët kolegu Kurteshi, me besimin dhe shpresën që ato sa më parë të jetësohen dhe të zbatohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Islam Pacolli, pa grup parlamentar.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar!

Sigurisht se sot është një temë e rëndësishme që jemi duke e trajtuar, por kisha pasur dëshirë që kjo temë që trajtohet sot të mos jetë vetëm pjesë e debatit, por ne të nxjerrim edhe vendime.

Historikisht Presheva, Bujanoci, Medvegja e deri te Molla e Kuqe ka qenë e Kosovës. Mendoj që sot është e rëndësishme, që ne t'i përkrahim ata fillimisht që të mos kenë standarde të dyfishta, duke marrë parasysh që ne në Kosovë i respektojmë të gjithë të tjerët dhe për ne janë të barabartë, e të mos them që nganjëherë kanë edhe të drejta më shumë se vetë ne këtu. Por, sot është një moment që ne të diskutojmë dhe t'i nxjerrim disa vendime, e të mos i lëmë vetëm vendime në letër, po të jetë vendim në vepër, të cilin ne do ta përkrahim atë anë atje, që me të vërtetë ka mbetur si një zorrë qorre pa asnjë përkrahje institucionale.

Ka kohë që filluar që do t'i përkrahim me libra, me njërën e me tjetrën, por realisht ne duhet të qesim kusht për përkrahjen e tyre. Sikur që ne i respektojmë të tjerët, edhe ata duhet të na respektojnë neve. Prandaj, kisha pasur një kërkesë, një propozim, që ne të mos i përkrahim vetëm me libra, por ne si Qeveri e Kosovës është një buxhet minimal, të nxirren 50 milionë në vit për atë pjesë, që ne t'i përkrahim financiarisht dhe politikisht, që ata të qëndrojnë në vendin e tyre me të drejta të barabarta. Si është e mundur që Serbia ka të drejtë të investojë në Kosovë, duke u thirrur se po i përkrahim serbët, të cilëve nuk u mungon përkrahja edhe nga ne, kurse ne të mos kemi të drejtë t'i përkrahim shqiptarët që janë atje dhe me të vërtetë është për keqardhje që deri më tani nuk ka pasur përkrahje financiare.

Sot ne u kërkojmë që të mos e lëshojnë vendin, por nëse nuk i përkrahim edhe financiarisht, do të jetë e pamundur kjo, duke marrë parasysh që të gjitha rrugët ua ka shkurtuar Serbia. Nuk janë me të drejta të barabarta, pastaj ata e kanë të vështirë të qëndrojnë. Prandaj, unë propozoj edhe një herë që kjo që po e propozoj sot të merret në konsideratë dhe të aprovohet, dhe të jetë një rutinë çdo vit nga Kosova. Pastaj, besoj që edhe Shqipëria do të marrë, duke parë Kosovën, edhe ajo ta bëjë të njëjtën gjë për këta bashkatdhetarë tanë, për këta qytetarë tanë, që fatkeqësisht i kemi jashtë kufirit, por historikisht kanë qenë me Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të gjithë deputetët do ta marrin fjalën. Askujt s'do t'i mohohet e drejta e fjalës. Ajo që dëshiroj të them është për organizimin e seancës. Nga ora 13:00, në qoftë se dëshironi ne shkojmë në drekë dhe pastaj vazhdojmë. Diçka që kisha pasur dëshirë po ashtu ta them nga deputetët. Do të ishte mirë, e përgëzoj komisionin, përkatësisht iniciuesit që e kanë sjellë këtë temë kaq të rëndësishme në këtë sallë të Kuvendit, por diçka që është po ashtu për ta thënë, është se Serbia nuk do ta dëgjojë atë çfarë do ta themi ne, përkundrazi ne duhet të bëhemi gati, sepse ata do të veprojnë edhe më keq ndaj tyre, në qoftë se ne nuk tregohemi pak më shumë të mençur, edhe në këtë vendimmarrjen që do ta marrim sot.

Për këtë arsye, unë kisha pasur dëshirë që më tepër të fokusohet, jo vetëm diskutimi, tre studentë të mjekësisë në qoftë se do të regjistroheshin, do të ishte mirë, do të ishte sukses i kësaj seance. 500 000 mijë euro në qoftë se do të shkonin në Preshevë, Medvegje e Bujanoc si investim, do të ishte mirë. Keni parasysh se ka edhe disa vështirësi, që Serbia do të mundohet t'u bëjë pengesë dhe të bëjë të kundërtën e kësaj që e themi ne. Komisioni iniciues është mirë që në fund të përgatitet dhe disa vendime që i marrim të zbatohen. Kjo është. Të mos jenë vetëm diskutime me t'ua vështirësojmë njerëzve tanë çështjen atje. Edhe për çështjen e shtetësisë, shikoni mirë a është mirë me marrë shtetësi të marrin shtetësi ata andej dhe t'i çregjistrojnë, siç po mundohen, apo është më mirë t'u jepet dokumente dhe t'ua organizojmë një jetë të dinjitetshme këtu, por jo t'i largojmë nga atje dhe t'i çregjistrojmë, pikërisht në fazën e dialogut kur është më e rëndësishme vendimmarrja edhe për Kosovën, edhe për ata vetë.

Unë po vazhdoj me deputetët tani. Në qoftë se dëshironi ta kufizojmë kohën, mundemi. Por, në qoftë se dëshironi, e lëmë 10 minuta. Në qoftë se ka marrëveshje 5 minuta çdo deputet, për hir që të mos... 5? Atëherë, po shkojmë me 5 minuta, regjia. Të mos t'i dekurajojmë njerëzit nga Presheva, Medvegja e Bujanoci, por në qoftë se ndonjë deputet insiston edhe 10 minuta, e ka fjalën. Marrëveshja është për 5, regjia le të shkojë me 5 minuta.

Imet Rrahmani e ka fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Do të mundohem ta them shpejt mendimin, për shkak se e kufizua kohën.

Sot po debatojmë për situatën e shqiptarëve në Kosovën Lindore në një seancë të jashtëzakonshme, që në fakt kjo do të duhej të ishte diçka shumë e zakonshme, sikur problemi për të cilin po bisedojmë të mos nxirrej në sipërfaqe vetëm në momente të caktuara dhe herë-herë vetëm për interesa individuale, grupore ose të momentit.

Përpos neve paralajmërimi i mbajtjes së kësaj seance ka lëvizur edhe përfaqësuesit politikë të popullatës shqiptare të asaj treve, duke na dërguar një letër, në të cilën radhiten të gjitha padrejtësitë që po përjetojnë shqiptarët atje. Aty numërohen të gjitha marrëveshjet e shkelura, marrëveshje këto të arritura mes shqiptarëve dhe shtetit serb dhe me ndërmjetësimin ndërkombëtar.

Në letër shprehen edhe disa kërkesa tejet modeste karshi asaj çfarë duhet të bëjë Kosova dhe Shqipëria. Natyrisht, që duhet falënderuar Këshillin Kombëtar Shqiptar për letrën, po ashtu duhet mirëkuptuar edhe angazhimet e tjera individuale dhe grupe për të na kontaktuar neve deputetëve, sepse qëllimi i tyre përveç bërjes së detyrës, është që të na informojnë dhe të na nxisin për diçka që ne do të duhej ta kishim obligim.

Sikur ne të politikës dhe bartësit e përgjegjësive institucionale në Kosovë të kishim në agjendën tonë ditore edhe zgjidhjen e problemit shqiptar në Kosovën Lindore, nuk do të kishte nevojë për letra e lobime, për angazhim të shqiptarëve, të shqiptarët, për shqiptarët. Sikur të kishte një angazhim më serioz dhe më të vendosur e më të përgjegjshëm në këto 20 vjetët e fundit, vargu i padrejtësive që po përjeton popullata shqiptare në Kosovën Lindore, e pakta do të ishte më e shkurtër dhe sot nuk do të flitej për shkeljen e të drejtave kombëtare sikur askund në Ballkanin Perëndimor dhe sikur askund në Evropë. Derisa Serbia ka prezantuar si të zgjidhur problemin e pakicave gjithandej në Evropë dhe botë, Kosova ka lëshuar shumë raste, ku problemi i pazgjidhur i Kosovës Lindore ka mund të diskutohej, të shpalosej dhe ndriçohet.

Unë mendoj se ne sot duhet të shohim se çka duhet Kosova të bëjë për realizimin e të drejtave politike të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe çka duhet bërë me të drejtat e përcaktuara të popullatës së shpërngulur nga ato vise prej përfundimit të luftërave me Serbinë.

Te kjo e dyta, të drejtat civile të përcaktuara deri tash, nga disa mijëra shqiptarë, disa edhe të lindur në Kosovë, mendoj se nuk mund të kemi ndonjë përfundim që arsyeton krijimin dhe ekzistimin edhe më tutje të këtij problemi. Në këtë çështje, kanë faj të gjithë ata që kanë pasur kompetencë dhe nuk kanë vepruar. Të gjithë ata individë dhe të gjithë ato parti që kanë neglizhuar zgjidhjen e problemit kaq gjatë. Me dhjetëra herë janë bërë angazhime nga deputetë, individë nga politika dhe parti të caktuara dhe asnjëherë nuk ka pasur një zgjidhje të duhur. E zgjidhja e duhur është njohja e të drejtës për nënshtetësi pa kushte.

Shumica dërmuese e këtyre qytetarëve janë duke jetuar në Kosovë nga paslufta, të shpërngulur për arsye të ndryshme nga trojet e tyre, e më së shumti nga pasiguria fizike. Të gjithë ata janë integruar në shoqëri, kanë ndërtuar shtëpi, kanë krijuar familje, disa kanë ngritur biznese dhe janë shembull pozitiv për komunitetin. Në shtetet e tjera, individë dhe familje që angazhohen dhe bëjnë hapa të duhur drejt integritimit në shoqëri, kanë përparësi në marrjen e lejeqëndrimit dhe

nënshtetësisë. Kjo nuk ndodh në Kosovë dhe për kë nuk po ndodh? Për shqiptarët në hall. Singërisht e pakuptueshme në rrethana normale.

Kjo pjesë e popullatës që për mua realisht janë banorë të Kosovës, shumica nuk kanë as dokumentacion të Serbisë. Ata e jetojnë jetën pa qenë të evidentuar askund. Ata thjesht nuk ekzistojnë. Iniciativa që ky problem të zgjidhet duke iu njohur të gjitha të drejtat, me përjashtim të të drejtës për votë, sado që e zbut problemin, është në kohë të kufizuar dhe jo e plotë. Unë mendoj që Kuvendi duhet të ftojë Qeverinë dhe Presidencën, që të bëjnë hapin e duhur dhe zgjidhja të jetë e plotë dhe e përhershme.

Një vullnet politik dhe i koordinuar mirë është obligim, sepse ata janë njerëz, e meritojnë dhe kanë të drejtë.

Është edhe një kategori tjetër e shqiptarëve nga Kosova Lindore që realizimin e të drejtës për shkollim të lartë në gjuhën e vet e realizojnë në universitetet e Kosovës. rinia e etur për dije dhe përgatitje profesionale po vazhdon të kërkojë të shkollohet në Kosovë, përkundër që Serbia nuk po i njeh ende diplomat e lëshuara nga institucionet tona. E sikur kjo nuk mjafton për problemet e tyre me bollëk, ne po u qesim pengesa që në rrethanat aktuale politike, nuk do të duhej të ndodhnin. P.sh. mjekët e porsadiplomuar kanë pengesa shtesë të panevojshme për të vijuar me praktikën e obliguar pas diplomimit, që ne e njohim si...

KRYETARI: Vazhdoja, të lutem!

IMET RRAHMANI: ...që ne e njohim si stazh i detyrueshëm gjashtëmuor, që është si paraprijës i licencimit të mjekëve.

Këto pengesa që ne, nuk ishin të shprehura më herët, duhet eliminuar. Sepse ata të rinj dhe të reja, shpresat për ngritje profesionale dhe ushtrimin e profesionit e kanë te Kosova dhe përmes Kosovës. Shumë mjek nga ato troje, edhe në rrethana të ngjashme, sot i kemi emra të njohur në mjekësinë kosovare dhe më larg.

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ne është dashur të bëjmë më shumë dhe u listuan se çka janë bërë deri tash. Por duhet të bëjmë edhe më shumë. Sidomos në realizimin e të drejtave politike të shqiptarëve në Kosovën lindore. Sepse vetëm kështu do të realizoheshin edhe të gjitha nevojat dhe projektet të cilat i cekën kolegët e mi parafolës.

E para, e drejta është në anën e tyre dhe në anën tonë. E drejta buron nga fakte historike. Ata janë shqiptarë dhe jetojnë në trojet e tyre stërgjyshore.

E dyta, kontributi i tyre për liri dhe identitet kombëtar, lëre që nuk mund të mohohet, por është i madh, dhe duhet vlerësuar shumë. Ata asnjëherë nuk u ndan nga trungu shqiptar, në asnjë rrethanë dhe në asnjë etapë të përpjekjeve të përbashkëta. Ishim bashkë në të mirë dhe në të keqe. Në paqe dhe në luftë.

Kosova lindore edhe sot është e gatshme të ketë mirëkuptim, është e gatshme të sakrifikojë vetëm e vetëm që Kosova si shtet të rritet e të zhvillohet. Por, Kosova lindore më nuk mund të mirëkuptoj që Prishtina zyrtare të mos e ketë me prioritet, në agjendë të bisedimeve me Serbinë, problemin e të drejtës së saj.

Nëse në këto njëzet vjet, në shumë procese nëpër të cilat është dashur të kalojë formësimi i shtetësisë së Kosovës, Kosova lindore nuk kishte vendin e duhur, tash është momenti që Serbia të kushtëzohet. Sa të drejta për minoritetin serb në Kosovë, aq të drejta për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Nëse Kosova lindore është e gatshme të sakrifikojë të drejtën e saj për bashkim me Kosovën, të shprehur në referendumin e vitit 1992, vetëm që të mos rrezikohet veriu dhe të mos dobësohet shtetësia e Kosovës, atëherë Kosova e ka obligim që të kërkojë me ngulm që të arrihet reciprociteti i plotë minimalisht.

Dhe e fundit, meqenëse jam i lindur në Malësi të Bujanocit, në fshatin Zarbicë, ku e tërë popullata me rrënjë nga atje, në Kosovë e diasporë po bën përpjekje për mbajtjen gjallë të jetës shqiptare, marrë të drejtën të them se shqiptarët nga Kosova lindore nuk do t'ia falin askujt ngjalljen e shpresave të rrejshme dhe lojën me ndjenjat, atdhetarizmin e bujarinë e tyre për interesa personale, sikur që do të jetë gjithmonë mirënjohës për të gjitha angazhimet e sinqerta, të përgjegjshme dhe kontributet me interes për ta dhe me interes kombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që e përcillni këtë seancë,

Injorimi i skajshëm i shtetit serb, dështimet afatgjate për të shfaqur një vullnet për zgjidhjen e problemeve themelore të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, respektivisht për integrimin e tyre në shoqëri, i jep përshtypjen se shteti serb, me të vërtet nuk i dëshiron ata të jenë në mesin e qytetarëve të vet, andaj shqiptarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, janë ndier përherë të tepërt, janë ndier të lënë të harruar nga bota.

Shteti serb në mënyrë permanente ka përdorë deklarata të rrejshëm sa i përket të drejtave të komunitetit serb në Kosovë, kur dihet në gjithë botën se Kosova ka të realizuar deri në atë shkallë të drejtat e serbëve këtu, sa definicioni diskriminim pozitiv është vënë edhe në leksikon tonë politik tani. Ndërsa, diskriminon me vetëdije në të gjitha aspektet, shqiptarët në Luginë, dhe jeta e tyre përngjan në vitet e 50-ta, pa rrugë të mira, ndërtesa të vjetra të parenovuara, pa investime, pa kulturë, pa shkollim. Thjesht ata vetëm mbijetojnë aty. Aty ishte një jetë pa ngjyra. Shteti serb ka filluar t'i ushtrojë disa praktika në raport me qytetarët shqiptarë në ato pjesë që askund në botë nuk ekzistojnë. Mungesën e shqiptarëve për disa muaj në vendbanimet e tyre, ata i penalizon me humbjen e shtetësisë.

Shqiptarët në Medvegjë, Preshevë, Bujanoc, përballen me diskriminim të skajshëm. Diplomat që marrin në Kosovë dhe vende të tjera shqipfolëse, atyre nuk u njihen. Ata nuk kanë mundësi të sigurojnë vende të dinjitetshme pune dhe jetojnë me ndjenjën që s'kanë shtet, sepse nuk ndihen si qytetarë me të drejta të barabarta.

Kuvendi i këshilltarëve shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës i pat koordinuar vendimet dhe politikat e shqiptarëve në këtë rajon kur miratoi deklaratën politike, ku ka kërkuar që në dialogun e Brukselit të zgjidhen edhe problemet e shqiptarëve të Luginës së Preshevës.

Kërkesa e tyre që e drejta e tyre të përfshihet në pjesën e bisedimeve në dialogun me Serbinë, ishte dhe është legjitime dhe humane. Pa paragjykuar se kur do të ketë një marrëveshje të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, nuk do të ketë stabilitet nëse nuk zgjidhen problemet e shqiptarëve në Luginë, ose lihen thjesht mënjanë çështjet thelbësore që ndeshen me problemet pra të shqiptarëve të Luginës.

Përfaqësuesit e këtyre anëve, në shumë takime me përfaqësues të liderëve tanë politikë dhe krerë të institucioneve, kanë shprehur kërkesat që të insistohet që të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë të jenë pjesë e dialogut në Bruksel. Bashkëkombësit tanë kanë nevojë të ndjejnë dorën tonë. Kanë nevojë për fonde të cilat do t'i zbusin sadopak në fushat elementare të jetës së tyre. Mirë që në këtë muaj ne pamë ministrin Abelard Tahiri që ishte dhe mori pjesë pra në investimin të cilin e financoi nga Ministria në Bujanoc. Dhe banorët atje u ndien të mos harruar në tërësi, por ende kemi shumë punë.

Vërtet ne kemi pasur problemet tona si shtet dhe kemi ende shumë, por jemi pak më shumë më komod sesa kemi qenë për të parë se bashkëkombësit tanë nuk trajtohen nga shteti ku jetojnë. Ne nuk i kemi ndihmuar deri tani për nevojat që kanë si bashkëkombës. Bashkësia ndërkombëtare s'i ka pasur asnjëherë në agjendë, dhe ende s'i ka.

Sot nga kjo seancë, të marrim me përgjegjësi iniciativat konkrete sepse vërtet ata i kanë sytë nga ne. Ata jetojnë çdo ditë me shpresën që diçka e re do të ndodhë në jetën e tyre. Ata kanë të drejtë

të kërkojnë një përkrahje nga ne. Në shekullin XXI, kur bota diskuton për digjitalizimin univers, ne po flasim pra për të drejtat elementare të njerëzve tanë në Serbi, në një shtet që synon integritet evropian, e në anën tjetër ua cenon me vetëdije e me plane të zeza të drejtën shqiptarëve në Luginë.

Ne sot jemi në këtë debat unik dhe do të bëjmë të qarta kërkesat tona, iniciativa, të cilat do t'i përcjellim pastaj në ministrinë përkatëse, të cilat nga kjo seancë do të dalin me obligime. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj e ka fjalën. Kërkoj falje. Ka të drejtë. Adem Mikullovc i qenka i pari. A shkojmë në bazë të radhitjes. Adem Mikullovc është i pari nga deputetët. Të gjithë, edhe nga Vetëvendosja, edhe nga të gjithë deputetët. Pastaj Rasimi, pasi ta dhashë fjalën dhe shkojmë në pauzë, bëhemi gati.

ADEM MIKULLOVCI: Ju faleminderit për respektin zoti kryetar!

Ju përshëndes të nderuar deputetë,

Në fillim pak do t'ju lodhi me histori. Shqiptari si komb, si qenie, i ka 27 plagë në trup. Tri fe, 12 fise, 12 tarikate. Dy shekujt e fundit i ka marrë tre grushte fort të fuqishëm, këtu llogaris Toplicën, eksodin e Toplicës, Çamërinë, edhe tash problem po na paraqitet Lugina e Preshevës, e cila për të folur të vërtetën, nuk ka qenë kurrë pjesë e Kosovës.

Ne duhet problemin e shqiptarëve të Preshevës ta bëjmë çështje. Duhet patjetër ta ngrisim në nivelin e çështjes në Kombet e Bashkuara dhe në Bruksel. Ne duhet të ngulim këmbë patjetër nga kjo seancë që t'i përkrahim propozimet që i dha Ismajl Kurteshi dhe të gjitha ato rezoluta, ato vendime të votohen, të përkrahen dhe të merret një qëndrim i qëndrueshëm, të qëndrojmë prapa e tyre. Nuk po e zgjas më tepër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj e Zafir Berisha paskan një urgjencë, pastaj shkojmë në pauzë.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit,

Në takimin e përbashkët të dy komisioneve parlamentare, atij të Arsimit dhe Administratës Publike, e kam përkrahur propozimin që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, sepse këtu në këtë Kuvend janë mbajtur me dhjetëra seanca të tilla, e në fakt asnjë situatë....

KRYETARI: Zoti Selmanaj a ka mundësi veç një reagim. Ka një propozim që në qoftë se kthehen deputetët e Kuvendit, ta votojmë rezolutën nga seanca e kaluar. Ta fusim në rend dite

dhe ta votojmë. Në qoftë se kthehen derisa ta përfundojë zoti Zafir Berisha, unë atëherë e vë në votim. Në qoftë se kthehen. Tash varet nga grupet parlamentare, kryetarët a mund t'i sjellin deputetët.

Kërkoj falje zoti Selmanaj, vazhdo të lutem! Faleminderit!

RASIM SELMANAJ: Tash më duhet të kthehem prej fillimit kryetar.

Në takimin e përbashkët të dy komisioneve parlamentare, atij të Arsimit dhe Administratës Publike, e kam përkrahur propozimin që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, sepse në këtë Kuvend janë mbajtur me dhjetëra seanca të tilla e në fakt asnjë situatë e asnjë temë e ngritur nuk ishte e jashtëzakonshme. Përkundrazi. Nga raportimi i disa kolegëve deputetë, të cilët ishin në vizitë atje, del se pozita e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc vazhdon të jetë diskriminuese në të gjitha segmentet e jetës, duke shtypur kështu edhe të drejtat njerëzore e kombëtare.

Kjo situatë atje të kujton kohën e regjimit të Milloosheviqi. As pushteti i sotëm i Serbisë sikur nuk dallon nga ai i djeshmi, ngase kanë fatkeqësisht të njëjtin mentalitet, madje vazhdojnë t'i kenë të njëjtat veprime, e politika diskriminuese antishqiptare.

Të nderuar deputetë,

Çështja sot duhet të ngrihet jo vetëm duke e përshkruar situatën atje, e duke ngritur shqetësime, por duhet pyetur veten ne këtu, çka shteti i Kosovës, në këtë rast, Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës duhet të bëjnë për Luginën e Preshevës?

Shteti i Kosovës duhet me prioritet t'i plotësojë disa prej kërkesave imediate, sepse këtë e kemi obligim shtetëror dhe kombëtar. Madje, pse jo edhe mision historik.

A duhet të përfundojë kjo seancë vetëm duke shprehur shqetësimin tonë e duke nxjerrë rekomandime? Unë mendoj se nuk duhet të jetë ky përfundimi i kësaj seance. Përkundrazi! Sot, detyrimisht Parlamenti duhet t'i marrë disa vendime të cilat e obligojnë Qeverinë e Kosovës që të ndërmarrë hapa konkretë në përkrahje të shqiptarëve atje. Ata sot kanë nevojë për përkrahjen e shtetit të Kosovës, pse jo edhe të Shqipërisë. Është në dorën e këtij Parlamenti që të krijojë Fondin për Luginën e Preshevës. Ne po ashtu mund dhe duhet të bëjmë më shumë në ndaljen e politikave diskriminuese ndaj shqiptarëve.

Të nderuar deputetë,

Ja një shembull. Kur Beogradi inskenon situata të paqena për të treguar sesi seerbër janë të rrezikuar nga 'terroristët shqiptarë' e që në këtë rast Serbia vihet në thonjëza në mbrojtje të serbëve.

Në zonën e sigurisë të KFOR-it në Deçan shfaqen disa grafitë të cilat edhe sot e kësaj dite, çuditërisht nuk dihet kush i paska shkruar. Në një rast tjetër, në muret e Manastirit të Deçanit janë shkruar grafitet UÇK-UÇK dhe në të dy raste gjenerali i KFOR-it dhe ambasadat ia kishin mësyre Deçanit. Beogradi kishte alarmuar bashkësinë ndërkombëtare për asgjë, ndërsa ne nuk po arrijmë të alarmojmë askënd e as veten për diskriminimin e shqiptarëve atje. E ne çfarë po bëjmë për ndaljen e politikave diskriminuese ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Deri sot pak kemi bërë.

Të nderuar deputetë,

Le të jetë kjo seancë si nisë serioze dhe kthesë në përkrahje konkrete për Luginën e Preshevës.

Ne duhet ta zbatojmë reciprocitetin ndaj Serbisë. Vendosija e taksës është një shembull tipik se Qeveria e Kosovës kur e ka përnjëmend, mund të zbatojë edhe reciprocitetin ndaj Serbisë, jo vetëm për mallrat serbe, por edhe në tema të tjera me interes, siç është rasti me të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Të drejtat që serbët i kanë në Kosovë duhet t'i kenë edhe shqiptarët në Serbi.

Dikush mund të thotë se Lugina duhet t'i bashkohet Kosovës. Kjo gjithsesi se është e drejtë e tyre dhe e jona historike, e cila do të ndodhë në një të ardhme të afërt, por deri atëherë ne duhet të jemi krah i tyre i fortë, duke i përkrahur shqiptarët e Luginës në të gjitha segmentet e jetës, sidomos në fushën e arsimit, kulturës etj. Kjo nuk e pengon sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008. Përkundrazi, Kosova dëshmon se është shtet serioz. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është zoti Zafir Berisha, edhe përgatitemi shkojmë. Në qoftë se nuk vijnë 61 deputetë për ta vënë në votim, atëherë do të shkojmë në pauzë.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zoti ministër,

Sot jemi tubuar për të rikonstatuar situatën të cilën e dimë të gjithë tash e dy dekada. Vlerësoj qëndrimin e kolegëve në atë pjesë të Shqipërisë etnike, pra në Kosovën lindore, që edhe një herë na kanë risjellë në Kuvend situatën, për të cilën besoj se e kanë ditur edhe ata para se të shkojnë. Në fakt, situata në atë pjesë të Kosovës, të Shqipërisë etnike, ose Kosovës lindore, është e njohur për të gjithë dhe unë po mendoj se ne nga fjalët e mëdha, nga retorika të kalojmë në veprime konkrete dhe për këtë mendoj se duhet të jemi më të qartë.

Të gjitha ato që u thanë, qëndrojnë, janë konstatime, por Kuvendi i Kosovës ka për obligim që nën një, t'i drejtohet edhe njëherë mekanizmave ndërkombëtarë të cilët përbëjnë bërjen e

politikës globale, por në të njëjtën kohë edhe të sigurisë për gjendjen në të cilën janë shqiptarët në Kosovën lindore dhe të gjitha që ato gjëra që u thanë, të potencohen edhe një herë në një shkresë, d.m.th. drejtuar këtyre mekanizmave dhe ne shumë shpejt presim që në Kuvend të vjen Korniza Buxhetore Afatmesme dhe të kemi një buxhet pse jo prej 10 milionë eurove. Nuk e gjen nami Kosovën, në rast se kemi një buxhet. Nga ai buxhet, do të aplikoj jo vetëm për kërkesa që u potencuan, por edhe për subvencione, për krijimin e një mirëqenie më të mirë për qytetarët tanë në atë pjesë.

Mua më erdhi mirë, të them të drejtën nuk po mund të kthehem në Prizren pa e potencuar që ngritja e nivelit politik të kolegëve që folën dhe që asnjëri nuk u morën me politikën e 'tyxharit' d.m.th. të Hashimit, i cili thjesht ka torturuar, jo vetëm banorët e asaj zone, po edhe të Kosovës, me akrobacionet e tij politike, për llogari meskine.

Situata në atë pjesë është ajo që është. Ju e dini se shqiptarët e asaj pjese kanë qenë pjesë e angazhimit të përbashkët të shqiptarëve për liri. Në atë pjesë ka pasur përpjekje të armatosur, ka pasur ndërhyrje të faktorit ndërkombëtar, që ka rezultuar me një marrëveshje, marrëveshje që thjesht nuk është zbatuar dhe një pjesë e faktorit ndërkombëtar nuk është risi të potencohet se shpeshherë na ka lënë në gjysmë të rrugës, prandaj po mendojnë se ky Kuvend duhet t'i shërbejë unifikimit të faktorit politik, kudo që jetojnë shqiptarë, dhe të reagojmë ashtu siç e meriton situata për të reaguar.

Edhe një herë, po e potencoj për fund, se një fond i cili u potencia, por edhe një shkresë drejtuar mekanizmave ndërkombëtarë për t'i radhitur të gjitha ato që u thanë këtu, është e domosdoshme. Pse jo edhe ideja e shokut Dugi, i cili foli për një Zyrë të veçantë në kuadër të Qeverisë, për të qenë bile së paku pastaj përmes Qeverisë edhe mekanizmat e tjerë, në mënyrë permanente për situatën në atë pjesë të Shqipërisë etnike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Administrata, ju kisha lutur, sa deputetë i kemi? Me aq sa po shihet, edhe kështu s'ka nevojë fare të konstatohet, se s'janë 61. Urdhëro Glauk! Ndërkohë, derisa shikojmë, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne kur propozuam atë procedurën e mbledhjes së përfaqësuesve nga grupet parlamentare për të ardhur deri te një konsensus sa i përket dokumentit që do ta qesim në votim sa i përket ndërprerjes së monopolit në homologim, ne menduam që kjo do të shkojë para pauzës, që nuk do të shpallet pauzë, po që do të votojmë këtu para pauzës. Pra, meqenëse ndodhi pauza, dhe siç po duket nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve, ju kisha lutur secilit për një sensibilizim të jashtëzakonshëm, sepse situata është ashtu, është dita e fundit. Sot nëse nuk e merr një vendim Kuvendi, dhe nëse nuk bashkëpunon Qeveria, edhe ministri me Kuvendin dhe me atë vendim të Kuvendit, automatikisht vazhdohet monopoli në homologim edhe deri në vitin 2029. Kështu që kërkoj nga ju të bëni thirrje për deputetët që është shumë me rëndësi, ose në ora

dy e gjysmë, ose në ora 3, të mblidhemi të gjithë. Meqenëse jemi pajtuar Vetëvendosja, LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja. Të gjithë janë nënshkrues të kësaj rezolute, që asnjë deputet. Edhe PSD-ja edhe të gjithë, edhe minoritetet, edhe të gjithë. Edhe Nisma tash. D.m.th. nuk po i besoni kualifikimit “të gjithë”.

Kështu që të mblidhemi dhe ta votojmë këtë dokument shumë të rëndësishëm.

KRYETARI: Zoti Sherifi, ju jeni kryetarë të grupeve parlamentare. Unë si kryetar e kam për obligim çdoherë t’ju thërras. Do të duhej të ishte në dinjitetin e kësaj seance të kishte më shumë deputetë. Po flitet për një pjesë të trojeve tona, njerëzve që kanë kontribuar shumë, po tash po ia jap edhe Bilallit fjalën, pikërisht për këtë arsye.

Është mirë që në ora 2.30 të jenë mbi 61 deputetë. Në dy e gjysmë të jenë mbi 61 deputetë. Urdhëroni, zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Po gjithsesi që sot grupet parlamentare në cilëndo kohë që të merremi vesh do të jenë bashkë, por një çështje kaq e ndjeshme, kaq sensitive është dashur të kryhet votimi atë ditë, dhe jo deputetët iniciues, sidomos kur ka përfunduar debati në tërësi, vetëm pesëmbëdhjetë kanë qenë në sallë. Pra, një çështje që sot po merr fundi, është dashur që mos lihej fare për sot, po të kryhet ditën e premtë. Gjithsesi që, përfaqësuesi ynë në komision ka dhënë mbështetje ndaj kësaj rezolute dhe do ta mbështesim edhe në Kuvend. Rëndësi ka, që sot brenda ditës të kalojë kjo, a në dy e gjysmë apo në tre ose katër, grupet parlamentare le të merren vesh me deputetët e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe njëherë për hir të korrektësisë. Në orën 14:30, të jenë të gjithë deputetët. Pauza do të jetë deri në 14:30. Të vijmë dhe të votojmë, për faktin se pastaj, unë po flas vetëm për... Këtë desha ta them Korab, për faktin se dikur pas orë 16:00, një pjesë e Grupit Parlamentar të PDK-së kanë aktivitetet.

Për këtë arsye kisha pasur dëshirë në 14:30, të jenë. T’i thërrisni sa më shumë grupet parlamentare dhe e vendosim në votim dhe e përfundojmë. Faleminderit! Do të thotë, kthehemi në 14:30. Ky është konstatimi.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë, po e vazhdojmë seancën ku ka mbetur. I fundit ka qenë, ka diskutuar përfaqësuesi i Nismës. Radha është te LDK-ja. Fjalën e ka zonja, Lirije Kajtazi. Lirija s'është këtu.

E kam parasysh, e kam parasysh. Faleminderit! Fjalën e ka Vjosa Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para përfaqësuesit gjashtë vjetësh, në këtë Kuvend kemi organizuar një debat parlamentar dhe një propozim për rezolutë të Kuvendit të Kosovës që do të merrej me të drejtat e shqiptareve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Për fat të keq, mbi 90% të çështjeve që i kam ngritur atë ditë, pra në qershor të vitit 2013, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, më duhet t'i përsërisë edhe sot. Për shkak se si rezultat i atij debati, ne patëm miratuar, thuajse unanimisht një rezolutë të Kuvendit të Kosovës, e cila kërkon nga ana e institucioneve tona që t'i ndërmarrin dhjetë masa konkrete.

Sot, duhet ta pranojmë që përkundër këtij zotimi thuajse unanim të Kuvendit të Kosovës në vitin 2013, Kosova nuk ka përmbushur asnjë zotim nga kjo rezolutë, përjashtojmë taksën për automjete e cila edhe ashtu është larguar me shumë vonësë.

Pra, sot gjendemi në një situatë të ngjashme dhe përsëri si Kuvend i Republikës së Kosovës, duhet ta themi thirrjen tonë për mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore për qytetarët e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, i cili sa i përket Republikës së Kosovës do të jetë kontribut për stabilitetin në rajon.

Përderisa shteti serb akoma po trajtohet nga Bashkimi Evropian, siç e kam thënë çdoherë në këtë Kuvend, si fëmijë i lazruar i Evropës dhe i privilegjuar. Po ashtu i njëjti shtet mbetet shkelësi më i madh i të drejtave dhe lirive themelore në tërë rajonin tonë.

Në fakt, në qoftë se e shikojmë regjistrin e Këshillit të Evropës, do ta shohim se përkundër faktit që Serbia është anëtare e kësaj organizate, është nënshkruese e pakteve për të drejtat e njeriut, konventave për të drejtat e njeriut dhe po ashtu Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila aplikohet drejtpërdrejt.

Sot e kësaj dite, shkel të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve shqiptarë dhe akoma i mbanë ata në tension dhe nën terror të vazhdueshëm.

Kolegët e mi deputetë, sot folën për shkeljet eklatante të këtyre të drejtave, duke përmendur shembuj specifik, në fushën e arsimit, në fushën e së drejtës, në fushën e shëndetësisë, në fushën e punësimit, në fushën e tregtisë dhe shumë të tjera.

Po ashtu u përmend dhe po e përsërisë çështjen e sigurisë, sepse mbajtja e këtyre qytetarëve nën terror të vazhdueshëm, po ashtu i vendos ata në një situatë tepër të pabarabartë me qytetarët e tjerë.

Akoma në këto komuna, mbeten të vetmet në Serbi në të cilat pandërprerë kemi forca speciale të xhandarmërisë. Forca këto që udhëhiqen nga Qeveria serbe, pra marrin urdhra nga ata.

Këto forca kufizojnë lirinë e qarkullimit dhe krijojnë ndjenjën e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Këtë e vërejmë sidomos në që shkojmë atje shumë shpesh, edhe për vizita zyrtare, por mbi të gjitha për vizita familjare dhe e shohim po e njëjta ndjenjë që secili prej nesh e kemi pasur në vitet e '90-ta.

Po ashtu, ka vazhdimisht shkelje të ligjit për amnistinë dhe të premtimeve të tjera që Serbia i ka dhënë sa i përket respektimit të të drejtave të qytetarëve.

Që të mos i përsërisë të gjitha ato vërejte që i kam thënë në vitin 2013 dhe që të mos dalim vetëm me propozime boshe, kërkohet që në rezolutën që do të votohet në fund, të bëhet thirrje e serishme për zbatimin e plotë të 10 pikave të rezolutës së vitit 2013.

Po ashtu, që në bashkëpunim me Shqipërinë dhe në përpurthje me Ligjin tonë për Financat Publike, të shikohet mundësia e krijimit të një fondi të zhvillimit, i cili do të adresojë çështjet emergjente në shëndetësi, arsim dhe mirëqenie sociale.

Në të njëjtën kohë duhet të dyfishohet numri i kuotave për studime në UP dhe në universitet tjera publike dhe të dyfishohen bursat për studentët nga kjo anë, në mënyrë që të krijohen kuadro të nevojshme dhe pastaj të shihen mundësitë sesi të mos krijohen barriera administrative që atyre t'u pranohen diplomat apo edhe praktikant.

Për sa i përket Kuvendit të Kosovës kishte edhe propozime të tjera. Mendoj që më e mira është në qoftë se ne në këtë Kuvend krijojmë një grup joformal të deputetëve për Preshevën, Medvegjen dhe Bujanocin, në mënyrë që njëjtë si grupi i grave deputete apo grupi i të rinjve ta marrim përsipër vullnetarisht të gjithë ne që kemi interesim që këtë të temë ta mbajmë në mënyrë permanente në agjendën e Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë, e jo vetëm njëherë në gjashtë vite, siç po ndodh tani.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Është shumë e rëndësishme që prapë Kuvendi i Kosovës po debaton për këtë temë. Është shumë e rëndësishme nëse ky Kuvend, pas atyre që janë zhvilluar edhe në këtë Kuvend edhe në institucionet e Kosovës, do të ndërmarrë ose do të bëjë diçka më shumë sesa një rezolutë për Luginën e Preshevës, për të drejtat e shqiptarëve që janë atje.

Unë personalisht, mendoj që janë dy grupe të çështjeve që duhet të trajtohen. E para, duhet të merremi me kërkesat e përditshme të tyre.

Ato janë siç u thanë edhe këtu, prej vështirësive që i kanë përditë me dokumente, me shkollim, me shëndetësi, me kalim të kufirit e tjerë, që duhet t'u dalim në ndihmë si institucione të Kosovës, e deri të çështja kryesore e cila ka të bëjë me një bashkëveprim të detyrave që i e kemi të përbashkëta për një kauzë e cila, po mendoj, po shpresoj dhe jam i bindur që është një kauzë e përbashkët.

Edhe njëra edhe tjetra në njëfarë mënyre janë njëfarë improvizimi.

Sikur që është seanca e sotme. Edhe për këto çështje të grupit të parë, është një grup i deputetëve të Kuvendit të Kosovës që fatmirësisht është për t'u lavdëruar që kanë ngre këtë temë në Parlamentin e Kosovës dhe është ky interesimi ynë siç është kjo seancë sot.

Mendoj që duhet ta shfrytëzojmë rastin që t'i falënderojmë edhe deputetët tanë, po veçanërisht përfaqësuesit e shqiptarëve atje me këto vështirës që i kanë, me një gjendje e cila u tregua sot nga shumica e deputetëve, madje edhe me shifra.

Të mos harrojmë se përpos gjendjes që janë atje, në gjendje të mjerueshme janë edhe disa mijëra persona që jetojnë në Gjilan, Viti dhe Kamenicë, të cilët janë të privuar nga të drejtat e tyre edhe këndeje edhe andej kufirit.

Dua t'i falënderoj të gjithë ata që janë drejtues të institucioneve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Përfaqësuesit politikë të Këshillit Kombëtar atje dhe t'i inkurajojmë që ata të vazhdojnë të punojnë për interesat e qytetarëve atje.

Po, çfarë po bëjmë ne? Mendoj që duhet ta shohim rezolutën që u përmend po ashtu, dhe të shohim që të gjitha pikat që ne jemi dakorduar, jemi zotuar në këtë Kuvend të Kosovës më 2013-ën, kanë të bëjnë me detyrime që ne i kemi nxjerrë para vetes.

Këto detyrime janë kryesisht për Qeverisë, ndërkaq sot kemi veç një ministër këtu, e jemi marrë vesh që të kemi angazhime konkrete edhe për çështje të sigurisë edhe për çështje të arsimit, edhe për çështje të shëndetësisë, edhe për hapjen e zyrës, që u kërkua këtu nga një deputet, në Qeverinë e Kosovës, edhe për çështjet të tjera.

Po ashtu, kemi detyrime që i kemi dhënë vetës si Kuvend i Republikës së Kosovës. Prej themelimit të universitetit publik në gjuhën shqipe e deri te angazhimi tjetër për angazhimin tonë në aspektin ndërkombëtar që kanë të bëjnë me respektimin e konventave ndërkombëtare e tjera. Mund të themi se kjo le shumë për të dëshiruar.

Nëse në këtë seancë ne nuk e bëjmë një bilanc. Nëse ne nuk tregojmë se ku kemi mbërri me ato zotime që i kemi marrë, zor se do t'i japim shpresë qytetarëve që jetojnë atje, se kemi një angazhim serioz.

Ata që jetojnë atje, fatkeqësisht jetojnë vetëm nga puna e tyre dhe nga një mbështetje e madhe e migracionit që e kanë edhe ata në vendet Perëndimore, ndërsa jetojnë në mëshirën e kohës dhe atyre që i bën regjimi i Beogradit, kryesisht për të drejtat e tyre që i kanë atje. Mirëpo, në anën tjetër ata jetojnë me shpresën që në Kosovë dhe në Shqipëri do të ketë mbështetje shumë-shumë më serioze për shqiptarët që jetojnë atje.

Çka duhet të bëjmë ne më tutje? A duhet të bëjmë seanca dhe të bëjmë rezoluta dhe të mos merremi kurrë me to? Normalisht që ka një grup njerëzish, institucionesh edhe komunash që kanë provuar dhe kanë bërë diçka më tepër në këtë drejtim dhe ajo është për t'u lavdëruar.

Por, në përgjithësi trajtimi i kësaj teme dhe sidomos trajtimi i kësaj teme me çështjet tona këtu, ngatërrimi shpeshherë i mesazheve ose dhënia e mesazheve të tilla çfarë ishin me rastin e trajtimit të çështjeve të bisedimeve Kosovë-Serbi, nuk ishte edhe mesazhi më i mirë për shqiptarët atje.

Ne kemi arritur që t'i nxjerrim në rrugë mijëra qytetarë...

KRYESUESI: Vazhdoja edhe një minutë, zotit Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Kemi arritur që në sheshin e Prishtinës t'i kemi mijëra qytetarë në kundërshtim të idesë për ndarjen e Kosovës dhe unë nuk e di se cili është mesazhi pastaj për ta, pavarësisht që ky nuk është njëfarë adresimi i shembullit tipik, por në anën tjetër kemi pasur një protestë të qytetarëve të Preshevës e Bujanocit dhe vetëm disa dhjetëra qytetarë të Kosovës janë bashkuar në mbështetje të kërkesave të tyre legjitime për mbrojtjen e kërkesave të tyre legjitime.

Unë i ftoj të gjithë që të jemi më serioz. Të jemi më të angazhuar, jo vetëm në respektimin e të drejtave të tyre, po në respektimin e detyrimeve që i kemi marrë ne si Kuvend për t'ju dalë në mbrojtje qytetarëve shqiptarë që janë të privuar nga të drejtat e tyre në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje të nderuar qytetarë,

Është interesante se derisa po flasim për situatën aktuale të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe veçanërisht për angazhimin e institucioneve të Republikës për të drejtat dhe vështirësitë e tyre, të mos e kemi kryeministrin e Kosovës të pranishëm në këtë seancë, kjo sigurisht është për të të ardhur keq.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me vonesë po thërret një mbledhje për të diskutuar situatën aktuale të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Në të vërtetë institucionet e Republikës së Kosovës, jo vetëm Kuvendi i Kosovës, do duhej të ishin aktive dhe në mbështetje të shqiptarëve në Kosovën Lindore. Madje, edhe Republika e Shqipërisë, jo vetëm për arsye të spektakleve, jo vetëm me përkrahje morale, por edhe dora e zgjatur e dy Republikave shqiptare, do duhej të ishin shtyllë institucionale për gjendjen socio-ekonomike të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Në vend të keqpërdorimeve që i bëjnë politikanët karshi qytetarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të cilat Thaçi për motivet e veta të ulëta dhe për ndarjen e Kosovës, i vendoste njerëzit para ekraneve televizive, duke i renditur para gazetarëve dhe fliste për bashkimin e Kosovës Lindore me Kosovën, ndërsa botërisht dihet se pazaret e tij më vëllain e tij Vuçiqin, ishin ndarja e Kosovës për ta bërë më të thellë ndarjen dhe jo për ta bashkuar.

Pra, territorin edhe ashtu të ngushtuar ta bënte më të gjerë për Serbinë.

Në njërën prej seancave të Kuvendit të Kosovës, është diskutuar për reciprocitetin e plotë tregtar e politik me Serbinë, me ç'rast disa deputetë thirreshin në reciprocitet duke aluduar jo drejtpërdrejt në reciprocitet me Serbinë në relacion me shqiptarët në Kosovën Lindore.

Lëvizja Vetëvendosje më 7 dhjetor të vitit 2011, pati shtruar një mocion i cili edhe fatmirësisht ishte miratuar. Dhe, në këtë mocion thuhej:

1. Qeveria t'i marrë masat e reciprocitetit të plotë tregtar, ekonomik e politik me Serbinë.
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta nxisë dhe udhëheqë bashkëpunimin me prodhuesin vendor dhe ndërmarrjet tregtare për gjetjen e zëvendësimeve për produktet e importuara nga Serbia.
3. Qeveria t'i forcojë të gjithë mekanizmat shtetërorë për ta siguruar zbatimin e përpiktë për masat e reciprocitetit me Serbinë.

Sigurisht, se këtu disa herë është diskutuar edhe për reciprocitet sa i përket teksteve shkollore në Luginë.

Kjo rezolutë e Kuvendit të Kosovës ishte mbrojtur nga qytetarët e Republikës së Kosovës, me përplot arrestime masive e lëndime të qytetarëve. Prandaj, na duhet një rezolutë e Kuvendit, pothuajse e njëjtë, veçse të shtohen disa pika rreth reciprocitetit të të drejtave kombëtare për shqiptarët në Kosovën Lindore, njëjtë siç i kanë serbët këtu.

Pra, të drejtat e tyre themelore të përdorimit të gjuhë, simboleve kombëtare, arsimimit e teksteve shkollore, pranimit të diplomave, targave të automjeteve e tjera e të tjera.

Qeveria e Kosovës, duhet të parasheh mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe fatkeqësisht ky buxhet i ndarë keqas, buxhet elektoral i PAN-istëve, nuk ka paraparë asnjë cent të vetëm për shqiptarët në Kosovën Lindore, sepse Qeveria e Kosovës nuk e ka përnjëmend dhe nuk e ka pasur kurrë prioritet, Kosovën Lindore.

Dhe, jo vetëm Qeveria e Kosovës, por edhe ajo e Shqipërisë do duhej që ta parashihte të njëjtën gjë.

Përfaqësuesit politik të shqiptarëve të tri komunave në Jug të Serbisë, Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, kanë kërkuar që në kuadër dialogut dhe marrëveshjes politike që pritet të arrihet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të futet si çështje edhe zgjidhja e këtyre tri komunave.

Asnjë fjalë për të drejtat e tyre në dialogun me Serbinë dhe demagogjinë nga Thaçi në Kosovë për bashkimin e tyre, e që synonte të kundërtën.

Në vend se të kërkonte reciprocitet për të drejtat e shqiptarëve, ai i la ata pa mbështetje politike, ndërsa Qeveria edhe pa mbështetje ekonomike.

Popullsia shqiptare në Luginën e Preshevës nuk dallon nga popullsia shqiptare në Kosovë dhe viset e tjera. Ajo karakterizohet me popullsi të re me moshë mesatare rreth 28 vjet. Prandaj, Qeveria e Kosovës do të duhej të investonte në këto vende dhe të marrë në mbrojtje shqiptarët atje, sepse ata qëndrojnë më poshtë se të tjerët edhe në fushën e arsimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja edhe një minutë!

ARBËR REXHA: Pra, atje shqiptarët qëndrojnë në pikëpamje ekonomike, sociale, arsimore e kulturore, madje edhe shëndetësore, pra më poshtë dhe komuniteti më i pazhvilluar në Serbi për nga të ardhurat kombëtare është 5 herë nën mesataren e Serbisë.

Dhe, duke i ditur këto treva të Luginës së Preshevës, komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, përfshijnë territor prej 1250 kilometra katrorë, në të cilat jetojnë rreth 100 mijë shqiptarë, por janë shumë më pak të përqendruar në rreth 65 fshatra dhe 3 qendra urbane.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e dimë që këtë seancë e kanë thirrur komisionet parlamentare, të cilat kanë pasur angazhim në territorin e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit për gjendjen e shqiptarëve atje dhe ndërkohë na vjen një rezolutë, e cila është nga presidenti, po që s'ka të bëjë me thirrjen e kësaj séance, për momentin nuk është mirë që të përzihen gjërat edhe kompetencat në një ngjarje të tillë kur bisedojmë vërtet për pozitën e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë, Bujanoc.

Prandaj, ne bazohemi në rezolutën që është lexuar nga kryetari i Komisionit për Arsim, zoti Kurteshi dhe pikat e asaj rezolute i kemi parasys.

Një që dua ta them që është më tragjike që po ndodh në atë territor është se po bëhet pasivizimi i adresave dhe humbja e identitetit të njerëzve, të cilët e kanë vendlindje të tyre dhe kjo është shumë e rëndë për shkak se e zvogëlon numrin dhe e ndryshon përbërjen nacionale në atë pjesë.

Po ashtu kemi të bëjmë edhe me një udhëzim administrativ, i cili siç kam njohuri, është nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, e që do të duhej të ishte ministri këtu për të sqaruar se a janë përgatitur të gjitha procedurat me këtë udhëzim, në mënyrë që qytetarët e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit që jetojnë në Kosovë të pajisen me dokumentacion, i cili u garanton një jetë normale në shtetin tonë.

Ajo që konsideroj se është themelore, është hapja e një zyre komunikuese, e cila çdo ditë do të përcillte ngjarjet dhe pozitën e shqiptarëve atje, duke komunikuar drejtpërdrejt me institucionet e shtetit të Kosovës dhe kështu do të mund t'i mbrojmë të drejtat e tyre.

Dhe përfundimisht mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë një Komision Parlamentar Monitorues, i cili çdo pikë të rezolutës do të shikonte se është zbatuar apo nuk është zbatuar dhe kështu ne të fillojmë me hapa konkretë ta ndryshojmë gjendjen e qytetarëve tanë në trevat e tyre.

Nëse vazhdojmë me rezoluta, të cilat nuk i përfillë kush dhe nuk i respekton, madje as nuk i zbaton, atëherë del që ne veç po nxjerrim rezoluta koti dhe nuk po bëjmë veprime konkrete, të cilat mundësojnë ndryshimin e gjendjes atje.

Prandaj, konsideroj se këto pika të cilat u përmendën, pa i përsëritur duhet të jenë çështje e zbatimit konkret dhe t'i lëmë fjalët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Pa dyshim se është një seancë jashtëzakonisht e rëndësishme. Unë nuk do të zgjatem shumë, por vetëm do t'i them dy fjalë që të drejtat edhe liritë e qytetarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit nuk mbrohen nëpërmjet debateve në Parlament, po përmes një interesim të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Unë po e them haptas që asnjë qeveri e Republikës së Kosovës nuk ka pasur dhe akoma nuk ka një zyrë të veçantë, e cila merret me studimin e problemeve të shqiptarëve në këtë regjion, ku ata jetojnë.

E dyta, punësimi i shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës, është baras me zero.

Dhe, e treta, për të treguar se sa kemi qenë të interesuar për këtë pjesë të kombit shqiptar, në thonjëza, flet fakti se i kemi diku 20 mijë qytetarë, të cilët nuk e gëzojnë nënshtetësinë e Republikës së Kosovës.

Tani le të më shpjegojë mua dikush kur ne po lypim që Shqipëria të na e njohë blanko nënshtetësinë e dy milionë shqiptarëve të Kosovës, kush na ka penguar neve që këtyre qytetarëve t'ua garantojmë të drejtën e fitimit të nënshtetësisë.

Unë kam shumë miq nga Lugina, kam edhe kolegë gazetarë, të cilët kanë ardhur edhe janë ankuar që nuk e kanë të drejtën e nënshtetësisë dhe jetojnë tamam si refugjatë në këtë vend.

Prandaj, këto tri rekomandime do t'i kisha për Qeverinë e Kosovës, edhe në të ardhmen në mënyrë institucionale të ndihmohen këta njerëz.

Përtej kësaj, çdo gjë tjetër është demagogji, ashtu qysh është demagogji edhe rrenë e kulluar ajo teoria se shumë shpejt do t'i bashkojmë Medvegjinë, Preshevën edhe Bujanocin me Kosovën, sepse ne shohim ëndrra dhe ka njerëz që shohin ëndrra dhe mendojnë se bashkimi kombëtar arrihet përmes poezive.

Çështja kombëtare nuk është poezi e Halil Matoshit, as poezi e ndonjë poeti tjetër, kombi nuk bashkohet përmes poezive, po përmes veprimeve praktike të shtetit, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë.

Ne flasim për afrim me Shqipërinë dhe Kosovën, ndërkohë që Qeveria e Shqipërisë, edhe pse jeton nga turizmi i Kosovës, na ka vënë atje një gjobë 5 euro taksën rrugore, 5 euro andej, 5 euro këndej dhe ne nuk kemi pasur asnjë lehtësim doganor për shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, por të gjitha kompanitë që kanë futur mallra në Kosovë i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë sikurse kompanitë serbe.

Hajde ua lehtësojmë jetën atyre njerëzve, atëherë dëshmojnë se jemi gjysmëpatriotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne kemi kuorumin sipas kërkesës dhe vendimit që e morëm së bashku. Ftoj zotin Zharku që ta paraqesë tekstin që e kanë miratuar si grup i përbashkët dhe pastaj futemi në votim. Zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Në bashkëpunim të plotë me të gjitha grupet parlamentare jemi marrë vesh për rezolutë. Teksti i rezolutës është si vijon:

1. Menjëherë të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ 2/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore i Ministrisë së Infrastrukturës,
2. Menjëherë të fillojë plotësim-ndryshimi i Ligjit për automjete, ashtu që të jetë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe MSA-së,
3. Në afat prej 2 muajve të miratohet Udhëzimi i ri administrativ, i cili duhet të jetë në përputhje me Ligjin për automjete, Ligji për mbrojtje të konkurrencës dhe rekomandimet e Zyrës së BE-së në Kosovë,
4. Në afat prej 6 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi, të liberalizohet plotësisht tregu i homologimit të automjeteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, një pyetje e kam zoti Zharku: A e keni harmonizuar të gjitha grupet parlamentare, apo ka dikush kundër, në emër të grupit.

LUTFI ZHARKU: Po, po, të gjitha grupet parlamentare, është i nënshkruar prej të gjithëve.

KRYESUESI: Në emër të grupit parlamentar, po merre fjalën zoti Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Është e vërtetë, e kemi harmonizuar tekstin, pika 4 e ka një gabim të vogël, thuhet: “Në afat prej 6 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi”, ne jemi marrë vesh që ky të mos jetë vendim, po rezolutë, kështu që them që kjo duhet të korrigjohet dhe të jetë “nga data e miratimit të kësaj rezolute”, vetëm kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zharku, urdhëro!

LUTFI ZHARKU: Po, nënkryetar, gabim teknik është. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, konsiderohet i miratuar propozimi i zotit Nitaj që të harmonizohet edhe kjo në rezolutë. Regjia dhe sekretaria në përpilimin e tekstit, hiqet “afati 6 mujor”, por miratohet “rezoluta”.

Regjia dhe deputetët përgatitemi për votim, votojmë tani:

E përsëris edhe një herë votimin. Në sallë jemi 65 deputetë, nuk kanë votuar shtatë deputetë. E përsëris edhe një herë votimin, ju lus, a ka dikush pa kartelë, së pari po ju pyes.

Zotit Nait Hasanit e ka fjalën.

NAIT HASANI: Nënkyetar!

E kemi ngarkuar me rezoluta joformale, në bazë të Kushtetutës, rezolutë do të thotë joformale, vendimin e kemi obligativ. Nëse duam ta ndërprejmë Udhëzimin administrativ për homologimin, duhet vendim të marrim. Kjo seancë duhet të marrë vendim për ndërprerje, nëse duam ta ndalim, nëse nuk duam ta zgjidhim këtë çështje, marrim rezoluta dhe këtë e zgjasim pa kufij. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë e kam propozimin për rezolutë, kështu që nuk mund të bëj vendim. Në qoftë se ju doni të bëni vendim, prapë unë e nxjerr në votim.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Edhe një herë e përsëris votimin, votojmë tash!

Kemi 64 vota, 62 janë për, asnjë kundër dhe 2 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi rezolutën që e heq monopolin lidhur me homologimin e veturave në Kosovë. Faleminderit!

Po e vazhdojmë seancën. Ministri Bytyqi e ka fjalën për një sqarim nga ana e tij si ministër i Arsimit.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ajo çka u tha deri më tani lidhur me gjendjen e qytetarëve në Luginën e Preshevës vërtet tregon për një gjendje të rëndë të këtyre qytetarëve, të cilët jetojnë në vendlindjet e tyre.

Ajo çka është më shqetësuese sot qytetarët e Luginës së Preshevës jetojnë në një terror në fushën e sistemit arsimor. Serbia nuk duhet të lejojë të përdoret terror në sistemin arsimor, sepse përmes terrorit të sistemit arsimor, është duke ndodhur spastrimi etnik në heshtje.

Sot jemi dy shtete, Kosova dhe Shqipëria, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë që të kemi një spastrim etnik në heshtje. Konsideroj që duhet të kemi veprime dhe jo vetëm diskutime. Veprime duhen të jenë të dyanshme. Veprime brenda territorit të Kosovës dhe veprimet direkt në Luginë.

Veprime të cilat mund të ndërmerren në territorin e Kosovës janë shumë më të lehta se ato që shteti duhet t'i ndërmarrë në pjesën e Luginës.

U diskutua për çështjen e kuotave të studentëve, për një veprim brenda territorit të Republikës së Kosovës, i cili është i lehtë për t'u bërë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është duke shikuar se sa është e nevojshme rritja e kësaj kuote dhe për këtë arsye sivjet kemi marrë vendim që të jetë 2% në regjistrimin e studentëve.

Po ashtu në takimin e përbashkët që kemi pas me Këshillin Kombëtar të Luginës më 3 qershor, jemi dakorduar për shumë veprime të përbashkëta, për të gjitha këto veprime prapë kanë të bëjnë me veprime brenda territorit të Republikës së Kosovës, siç janë trajnimet e mësimdhënësve që do të futen në kalendarin e trajnimeve të mësimdhënësve të tjerë, po ashtu edhe pjesëmarrja e nxënësve në shumë aktivitete të përbashkëta që bëhen me Kosovën dhe Shqipërinë.

Por, çka është më e rëndësishmja dhe çka është për të ardhur keq, ne mund të rrisim numrin e kuotës së studentëve për të kryer studimet në Kosovë, por çka do të thotë kjo kur një mjek, i cili përfundon sot studimet në Kosovë, nuk mund t'u shërbejë qytetarëve në Luginë, sepse nuk i njihet profesioni, gjegjësisht nuk i njihet diploma.

Çka do të shërbejë një mësimdhënës, i cili përgatitet në Kosovë, por nuk mund t'u shërbejë nxënësve në vendlindjen e tyre.

Pra, këto janë veprime të cilat kërkojnë veprime urgjente, por kërkojnë veprime shtetërore. Ne mundemi si institucion individualisht ta përkrahim Luginën, por që të kem një përkrahje të vazhdueshme, duhet të kemi përkrahje shtetërore.

Pra, ne mund të çojmë edhe laboratorë, ashtu siç jemi dakorduar në shtator të shkojnë dy laboratorë për dy shkolla ose të bëjmë edhe riparimin e shkollave, por kjo është vetëm një veprim individual i një institucioni dhe nuk e zgjidh problemin e qytetarëve të Luginës.

Andaj, një rezolutë e cila do të saktësonte veprimin e përbashkët shtetëror, unë konsideroj që do ta ndihmonte që ta ndalë njëherë e përgjithmonë spastrimin etnik të heshtur të Luginës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kërkoj falje, por është një kërkesë që të mblidhen përfaqësuesit e partive të grupeve parlamentare për ta harmonizuar tekstin që duhet ta miratojmë lidhur me çështjen që po e diskutojmë. Mendoj që kryetarët e grupeve ose përfaqësuesit, ose komisioni në fjalë duhet të takohen dhe ta shqyrtojnë çështjen e tekstit që duhet të miratohet.

Unë thashë që grupet parlamentare ta caktojnë nga një përfaqësues për ta harmonizuar tekstin e propozuar ose tekstin që e ka diskutuar komisioni lidhur me këtë çështje. Unë nuk e di grupet parlamentare kënd e kanë të caktuar në këtë çështje apo janë vetëm anëtarët e komisionit, vendosin vetë grupet parlamentare dhe zoti Kurteshi si kryetar i komisionit mund ta trajtojë çështjen.

Po vazhdojmë me diskutimet, fjalën e ka Blerta Deliu. S'është! Fjalën e ka Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Jo, e kërkoja më herët për propozim, nëse nuk jemi duke i propozuar tash, e marr fjalën kur të më vijë rendi t'i jap propozimet për ta harmonizuar rezolutën. Ose po e bëj tani nëse jemi duke e bërë tani, ose më vonë. Ok, atëherë tash nëse si grup e propozojmë zonjën Besa Baftiu.

KRYESUESI: Mirë! Atëherë, kush ka diskutuar më herët, po s'është e paraqitur, Bilall, po shtype, Bilall, zoti Sherifi e ka fjalën. Atëherë, mirë Albulena. Në këto grupe s'ka nevojë të caktoheni me deklaram.

Zoti Ali Lajçi e ka fjalën për debatin në fjalë.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Çështja e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës është një çështje shumë komplekse dhe në radhë të parë duhet parë si çështje politike, arsimore, kulturore dhe madje ekzistenciale. Kur themi kështu, historiku i këtyre viseve shqiptare atje është kaluar mjaft me heshtje dhe përkundër

tentimeve dhe vullnetit të asaj ane, e cila faktikisht është legjitime, e çmueshme dhe duhet të jetë në konsideratë të vazhdueshme ç'prej referendumit e këtej.

Në këtë kontekst, ne duhet të heqim disa paralele në mes të zhvillimeve politike dhe qasjeve konceptuale, të cilat janë bërë në drejtim të zgjidhjes së këtyre çështjeve, në radhë të parë mund të themi të çështjes kombëtare, sepse shpesh ne e trajtojmë këtë çështje si çështje të barabartë ose reciproke mes dy etnive, siç janë serbët në pjesën e Veriut apo gjetiu, kurse shqiptarët në ato vise atje, të cilat si reciprocitet nuk do t'u shkonte në harmoni edhe barabartë me çështjet që trajtohen si çështje nacionale, madje edhe çështje etnike, e politike në mënyrë të veçantë. Kur themi reciproke ne nuk mund t'i i trajtojmë njëjtë, për arsye se reciprociteti do të na vërë në një pozitë shumë inferiore, madje defensivë politiko-kombëtare rreth atyre viseve tona dhe populli shqiptar atje si autokton, në radhë të parë, kurse shteti serb historikisht ne e dimë se është krijuar mbi shtratin e territoreve shqiptare dhe serbët në kuadër të Republikës së Kosovës janë një etni që ka statusin e tij, duhet të ishte minoritar, kurse Presheva, Bujanoci dhe Medvegja janë çështje të atributit kombëtar autokton. Prandaj, në këtë mes politika serbe është ajo e trajtuar tash e mbas kundër këtyre etnive, sepse ka shprehur modelin e vet politik kombëtar edhe më herët, por edhe tash e vazhdon si të njëjtë në këtë kohë mjaftë të çuditshme kur kemi para vetes norma, rende dhe statute të reja, të cilat i definojnë ndryshe të drejtat e njeriut deri te ato kombëtare.

Prandaj, këto vise dhe populli shqiptar në Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc kanë të drejtë të lidhen dhe t'i bashkëngjiten Republikës së Kosovës si një tërësi, edhe është vullnet i tyre dhe duhet të pranohet, kurse serbëve sigurisht duhet t'u garantohen të drejtat e tyre si pakicë me konventa ndërkombëtare, po pa vendosur reciprocitetin e tyre për ndarje që nganjëherë reciprociteti do të na sillte në një pozitë të barabartë të këtyre dy raporteve, të cilat nuk janë të drejta. Në këtë mes, kur flasim për politikën e sotme, fatmirësisht Republika e Kosovës sot është shtet sovran edhe i pavarur dhe asnjëherë në histori nuk do duhej të ishte më e favorshme qasja rreth Preshevës e Bujanocit, ne përkundër kemi kaluar në një neglizhencë apo disfavoritet dhe nuk u kemi kushtuar kujdes atyre. Çështja e administratës atje, e të drejtave ekonomike, politike, madje arsimore është përtokë, siç ka qenë gjatë historisë, edhe sot. Prandaj, ne duhet që gradualisht t'i kthehemi me përkrahje buxhetore, e cila s'ka qenë deri sot dhe janë bërë mjaft hipokrizi rreth atyre viseve dhe t'i fuqizojmë ato, sidomos edhe Shqipëria. Prandaj, kur jemi këtu kurrsesi nuk guxojmë të shkojmë me attribute të barabarta, sepse Serbia sot synon jo vetëm komunat e Veriut atje, por deri te Ura e Ibrit, e cila edhe sot nuk është aktive për shkaqe gjeopolitike, gjeostrategjike, ndoshta edhe të vijave të tjera jashtë Kosovës.

Prandaj, në qoftë se Serbisë i jepet një reciprocitet i tillë, i trajtuar të këtyre dy çështjeve, atëherë Serbinë duhet të jemi të gatshëm ta presim te Ura, përndryshe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Tema që po diskutojmë është me rëndësi dhe e përsëritshme. Mendoj që sot është dashur të trajtohen tri çështje ose të jepet përgjigja: pse nuk është realizuar rezoluta e 2013-ës, apo çka është realizuar nga ajo rezolutë, e cila ka qenë po ashtu rezolutë e dalë nga Kuvendi dhe e cila ka mbetur e heshtur deri më tani dhe asnjë pjesë të asaj rezolute dhe asnjë nen nuk po e shohim, ose s'po e marrim një informacion nëse është zbatuar.

Nën dy, mendoj se është dashur të diskutohet që gjashtë vjet në bisedime mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, pse nuk është trajtuar kjo çështje? E nëse është trajtuar, çka është trajtuar dhe çka ka ndonjë konkludim, i cili mund t'u shërbejë më tutje bisedimeve në raport Kosovë-Serbi. Dhe, nën tre, mendoj që është dashur të jepet një përgjigje nga institucionet apo nga Qeveria pse 20 mijë qytetarë të Luginës së Preshevës nuk janë pajisur me dokumente që 20 vjet, të cilët jetojnë dhe dihet se nuk mund të lëvizin dhe të kthehen në vendlindjen e tyre. Ata kanë mbetur pezull, heshtur dhe të pamundësi në aspektin administrativ dhe dokumenteve zyrtare. Ne mund të pajtohemi me çfarëdo rezolutë edhe përmbajtje këtu, duke ngritur tema nga ato më nacionale e më rrahgjokset, mirëpo nëse nuk i zbatojmë sikur kjo që ka ndodhur deri më tani, kot bisedojmë, kot thirrmi këtu dhe sinqerisht duhet ta themi të vërtetën se edhe t'u kërkojmë falje bashkëkombësve tanë në Luginën e Preshevës për këtë neglizhencë dhe këtë mosseriozitet në trajtimin, e kam në trajtimin veprues të institucioneve të Republikës së Kosovës për të bërë diçka konkrete dhe reale për gjendjen e tyre atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht çështja që ne sot po e ngremë si deputetë të Kuvendit përmes seancës së jashtëzakonshme konsideroj se është më e gjatë se sa një kërkesë e jashtëzakonshme, ne e dimë se në çfarë gjendje jetojnë shqiptarët në Luginën e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Më mirë se ne, nuk e di kurrkush çfarë metodash përdor pushteti serbë atje, sepse të njëjtat metoda para 20 vjetëve, para luftës së Ushtrisë Çlirimtare i kemi përjetuar edhe ne si popull, edhe ne si institucione, në atë kohë paralele dhe kemi kaluar rrugën, të cilën po e kalojnë sot vëllezërit dhe motrat tona atje.

Ne e pamë rezolutën dhe e mbështesim si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, normalisht të jetë e harmonizuar me të gjitha grupet parlamentare. Unë si deputet edhe në vitin 2016, respektivisht në gusht të vitit 2016 e kam ngritur një çështje që ka të bëjë me Ligjin për

shtetësi edhe Ligjin për të huajt, do të thotë që vjen në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mendoj se ne si institucione mund të bëjmë më shumë, të mos i përsëris ato çka thanë edhe kolegët, por konsideroj që duke pasur parasysh se qytetarët e asaj pjese, pa dëshirën e tyre një pjesë e tyre jetojnë në Republikë të Kosovës, propozoj të iniciohet plotësim-ndryshimi përmes kësaj rezolute, se ne kemi thënë t'i pajisim në rezolutë me dokumente, por konsideroj që plotësim-ndryshimi i Ligjit për shtetësi, respektivisht Ligjit nr. 4/L-215 dhe Ligjit për të huajt, ku e rregullon mundësinë që ata qytetarë ta gëzojnë të drejtën, të cilët jetojnë nga viti 1999, 2000, 2001, 2002 që jetojnë në Republikë të Kosovës ta gëzojnë të drejtën të pajisen me dokumente zyrtare, deri të krijohen kushte më të mira që ata të kthehen në trojet e veta. Ne e kemi problem, unë kam diskutuar dhe kam pasur kontakte me shumë qytetarë të Luginës, kemi edhe miq personal, kanë probleme edhe pse jetojnë nga viti '99 në Republikë të Kosovës, kanë probleme, nuk kanë leje qëndrimi të përhershëm. Ajo u ndikon direkt në shkollimin e fëmijëve kur vjen në pyetje te bursat apo në integrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Unë e kam një informatë që Ministria e Punëve të Brendshme është duke e rregulluar me Udhëzim administrativ se qytetarët që dëshmojnë që kanë jetuar më gjatë se pesë vjet në Kosovë t'u jepet lejeqëndrimi i përhershëm. Unë propozoj që në të njëjtën kohë, pasi që Ligji për shtetësi e rregullon që qytetarët, shtetasit që jetojnë në Republikë të Kosovës mbi 10 vjet ta garantojnë apo të kenë të garantuar mundësinë të pajisen me shtetësi, unë propozoj që ata qytetarë të Luginës që dëshmojnë se kanë jetuar 10 vjet në Kosovë t'u mundësohet ta marrin shtetësinë dhe kërkoj që përmes kësaj rezolute të jetë më decisive do të thotë ndryshimi i Ligjit për të huajt dhe ndryshimi i Ligjit për shtetësi, që këta qytetarë t'i gëzojnë këto të drejta. Krejt në fund, kjo u ndihmon këtyre qytetarëve në integrimin e tyre deri të vijjnë ditë më të mira që ata të kthehen në trojet e tyre. Fakti se këta qytetarë nuk posedojnë shtetësinë e Kosovës dhe një pjesë e tyre nuk i posedojnë edhe lejeqëndrimet e përhershme, hasin në vështirësi të ndryshme, do të thotë nga qarkullimi, punësimi, shkollimi, marrja e bursave, zhvillimi i jetës normale në shoqërinë tonë.

Andaj, unë mendoj që çështjet, të cilat mund t'i rregullojmë ne si institucione, duhet t'i rregullojmë më shpejt, kurse normalisht që pajtohemi te ato pjesë ku ka të bëjë me reciprocitet dhe me atë pjesën kur do të bisedohet me Republikën e Serbisë, të bisedojmë për qytetarët e Luginës, në të njëjtën kohë të respektohet edhe referendumi i qytetarëve atje i vitit 2002. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A bën të di a keni marrë vendim për pesë minuta, a për 10 minuta, apo kush qysh donë? Se këta të Vetëvendosjes po thonë që vendimi është marrë, të diskutojë kush si do, unë nuk po di tash, nëse doni e bëjmë atëherë, mbetet në pesë minuta. Po këta po thonë 5, ju 10.

Duhet kulturë në diskutime... Fjalën e ka zoti Shemsi Sylja.

SHEMSI SYLA: Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Presheva, Bujanoci dhe Medvegja si tërësi përbëjnë një shtrirje gjeografike të një territori autokton, ku jeton një popullatë autoktone shqiptare prej rreth 100 mijë banorëve, që aktualisht përbëjnë rreth 80% të popullsisë së përgjithshme.

Medvegja, Bujanoci dhe Presheva përbëjnë një rajon, i cili sot e kësaj dite ka mbetur rajoni më i pazhvilluar në Serbi dhe në Ballkan. Këto tri komuna me shumicë shqiptare sot janë më se 7 herë më të pazhvilluara se mesatarja e Serbisë, kurse sot shqiptarët e atjeshëm kryesisht jetojnë nga të ardhurat që sjellin familjet e tyre që punojnë në vende të ndryshme të Evropës. Deri tash, fatkeqësisht Lugina e Preshevës u injorua në të gjitha takimet dhe nivelet nga faktorët politikë të Kosovës dhe të Shqipërisë. Në bisedimet ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë në prani të faktorit ndërkombëtar në Vjenë në vitet 2005-2007 Lugina u anashkalua krejtësisht, duke mos u zënë në gojë as emri i saj dhe i shqiptarëve të atjeshëm. E njëjta gjë ndodhi edhe në bisedimet e Brukselit, e po vazhdon edhe sot. E sa kanë shfaqur interesim Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë për ta ndihmuar këtë trevë shqiptare, mjafton të përmendet vendimi që patën marrë dy qeveritë në mbledhjen e mbajtur në Prizren, më 11 janar të vitit 2014, kur Komunës së Preshevës i patën premtuar ‘vitrat’ në shumë prej 100 mijë eurosh, secila nga 50 mijë, të destinuara për objektin e Maternitetit në Preshevë, e që me sa mbaj në mend unë, nuk iu dhuruan asnjëherë.

Në anën tjetër, këto vitet e fundit për shkak të moszhvillimit ekonomik të paramenduar dhe qëllimshëm të regjimit serb dhe represionit policor ushtarak të Serbisë, këto treva shqiptare intensivisht po boshatisen nga shqiptarët, jo vetëm selektivisht si përpara, por në procesin e braktisjes tani po shpërngulen familje të tëra dhe shumë vendbanime kanë mbetur pa njerëz, duke u mbyllur edhe shtëpitë. Megjithatë, shqiptarët e këtij rajoni ishin dhe mbetën në të gjitha rrafshet pjesë përbërëse e një tërësie me popullatë shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë, duke i ndarë vetëm një vijë artificiale, administrative, politike. Edhe në vitet e ‘60-ta, por edhe të ‘80-ta popullata e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit ishte shtytëse e proceseve të rëndësishme që ndryshuan epokë. Gjatë viteve të ‘90-ta shqiptarët e kësaj treve kanë dhënë një kontribut të çmuar, duke ndihmuar financiarisht familje të shumta në Kosovë që ishin përjashtuar nga puna dhe ishin po ashtu pjesë aktive në përkrahje të rezistencës kombëtare, duke marrë pjesë edhe në luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më pastaj ato organizuan edhe rezistencë ushtarake si përgjigje ndaj dhunës serbe që njihet me emrin e Ushtrisë Çlirimtare për Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë, e po ashtu ishin aktivë edhe në luftën e vitit 2001 që u zhvilluar në Maqedoni.

Pra, shqiptarët e Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevës kanë kontribuar në çdo proces, si në pikëpamje kulturore, arsimore, shpirtërore dhe kombëtare dhe si në të kaluarën, ashtu edhe sot çdo gjë të shqiptarët e Luginës është e lidhur me ata të Kosovës. Por, Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka pasur ndonjë projekt të veçantë, përpos gatishmërisë për të dërguar tekste

shkollore që nuk u lejuan nga Serbia. Madje, çka është edhe më keq, pas luftës së UÇPMB-së edhe pas një marrëveshjeje, përmes së cilës edhe u shpall një amnisti, edhe sot e kësaj dite ushtarët e UÇPMB-së ndiqen nga pushteti serb dhe nuk u lejohet kthimi në vendlindjen e tyre, e këta pjesëtarë nuk gëzojnë asnjë të drejtë nga Qeveria e Kosovës dhe trajtohen si njerëz pa atdhe në atdheun e tyre. Të gjitha qeveritë e deritashme në Kosovë nuk janë shquar për ndonjë zhvillim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Konsideroj që ideja e dy komisioneve parlamentare është e drejtë, është një çështje që është dashur si legjislaturë edhe më herët ta trajtojmë dhe uroj që kjo rezolutë të jetë përmbajtjesore, të jetë konkrete, të jetë në hap me kohën dhe zhvillimet që po ndodhin me bashkëkombësit tanë në Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë dhe uroj që si organi më i lartë legjislativ i shtetit tonë të mos manipulojmë me ndjenjat e bashkëkombësve tanë atje me premtime folklorike dhe me disa rezoluta që janë votuar edhe vite më parë, por nuk është bërë asnjë hap konkret drejt avancimit të drejtave të tyre.

Ne si Kosovë jemi në një proces sfidues me fqinjin tonë verior, Serbinë. Por, unë insistoј që si legjislaturë, si Qeveri, si institucione të një shteti të pavarur vërtet të orientohemi të gjithë në një pikë, të angazhohemi dhe të marrim vendim që edhe në procesin e ardhshëm të bisedimeve finale me fqinjin tonë verior, të drejtat e bashkëkombësve tanë në atë pjesë etnike të trajtohen në mënyrë të barabartë apo me parim reciprociteti, sikurse trajtohen komunitetet pakicë në Republikën e Kosovës apo edhe në rajon.

Kam një apel për partnerët tanë strategjikë, miqtë tanë që janë aq meritore për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. Vallë, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është i ashtuquajtur term “diskriminim pozitiv”, ne nuk duam diskriminim pozitiv për shqiptarët e Luginës, ne po duam trajtim njerëzor, trajtim të barabartë me qytetarët tjerë atje dhe po duam që të drejtat dhe liritë themelore, elementare të njeriut t’u respektohen.

Paramendoni kur një familje bën sakrificë ta shkollojë fëmijën e vet në një shtet tjetër, qoftë në Prishtinë apo në Tiranë, dhe ka probleme, që as në shtetet më totalitare nuk ndodhin, me nostrifikimin e atyre diplomave, me vazhdimin e angazhimeve tjera e mos të flasim për punësim. Statistikat në arsim, gjendjen atje në administratën publike po edhe në trajtimin e bashkëkombësve tanë atje, vërtet mund të krahasohen vetëm me shtetet diktatoriale. Prandaj,

duhet ta kemi një qëndrim parimor, duhet të jemi edhe autokritikë, që kjo rezolutë mos të jetë thjesht një copë letër e pavlerë, siç ka ndodhur me rezolutat tjera. Gjithashtu kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare që të bëjë presion te e përkëdhelura e Ballkanit Perëndimor, se ashtu si i trajtojmë ne komunitetet pakicë në Republikën e Kosovës të trajtohen edhe bashkëkombësit tanë atje.

Bëj apel edhe një herë, që si Parlament dhe institucione të shtetit të pavarur të jemi seriozë dhe të mos ndalemi, deri në realizimin e mirëfilltë të të drejtave të barabarta, sepse po pretendojmë që edhe ne edhe Serbia të jemi anëtarë të Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt, u thanë shumë gjëra nga kolegët deputetë dhe do t'i përmend vetëm disa prej argumenteve për hir të konsideratës që ne kemi për shqiptarët e Luginës.

Është Qeveria e Republikës së Serbisë e cila nuk po jetëson tri prej marrëveshjeve të cilat i ka firmosur me përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës në vitet 2001, 2009 dhe 2013. Janë këto tri marrëveshje që janë firmosur me praninë ndërkombëtare dhe procesi i integritit evropian duhet natyrisht që ta nxisë Serbinë që t'i plotësojë të gjitha standardet evropiane, sa u përket të drejtave individuale, por edhe sa u përket të drejtave kolektive të minoriteteve, që u tha edhe nga kolegët deputetë, që duhet të ketë një reciprocitet sa u përket të drejtave të shqiptarëve në Luginë dhe të drejtave që ne po i aplikojmë për komunitetet në Republikën e Kosovës.

Për këtë ka pasur edhe një deklaratë politike që është nxjerrë nga Kuvendi i Këshilltarëve Shqiptarë të Luginës së Preshevës, që është mbajtur më datën 14 korrik 2018 në Bujanoc dhe e cila e prodhon një deklaratë politike, me anë të së cilës kërkohen tri pika e të cilat janë: realizimi i plotë i të drejtave kolektive të shqiptarëve konform standardeve më të larta të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe të akteve të shpërmendura; monitorim të vazhdueshëm të Bashkësisë ndërkombëtare me qëllim të vlerësimit real të pozitës së shqiptarëve në Luginë të Preshevës, si dhe pika e tretë, që nga të gjitha palët pjesëmarrëse që në dialogun e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të përfshihet edhe pozita politike e shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe zgjidhja të kërkohet në aplikimin e parimit të reciprocitetit, me të drejtat e serbëve në veri të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, Kuvendi i Këshilltarëve Shqiptarë të Luginës së Preshevës e ka autorizuar Presidencën, Qeverinë, si dhe Parlamentin e Republikës së Kosovës, që në bisedimet përmbyllëse Kosovë - Serbi të vendosë mbi statusin politik të shqiptarëve të Luginës së Preshevës konform referendumit të marsit të vitit '92 dhe të dispozitave përfundimtare të platformës politike të janarit të vitit 2006. Do thotë janë këto parime të cilat kanë qenë kërkesa

kryesore të Kuvendit të Këshilltarëve Shqiptarë, mbi bazën e të cilave natyrisht edhe kjo ditë e sotme është vetëm inkurajim që të mos mbetemi vetëm në deklarata politike, por ky Kuvend të votojë një rezolutë, e cila vërtet do të ketë rol mbi pozitën e shqiptarëve në Luginë.

Natyrisht, thelbi kryesor janë raportet tejet të tendosura ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të cilat janë reflektuar me pasoja skajshmërisht negative në Luginën e Preshevës. Përkaj këtij fakti të pamohueshëm, me përjashtim të çështjes së njohjes së diplomave që u përmend në këtë seancë në relacionin Serbi - Kosovë asnjë çështje tjetër e ndjeshme me të cilën ballafaqohen shqiptarët e Luginës së Preshevës deri më tani nuk ka qenë temë e bisedave në Bruksel. Mirëpo, edhe kjo temë e përmendur që është trajtuar disa herë në Bruksel nuk është se ka dhënë rezultate konkrete. Ishte arritur fillimisht një marrëveshje që filloi të aplikohet me anë të Zyrës Spark dhe të Asociacionit të Universiteteve Evropiane, mirëpo ky aktivitet u ndërpre me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë të prillit të vitit 2014. Pas këtij vendimi ka pasur edhe disa takime të tjera që janë mbajtur në Bruksel. Ka pasur po ashtu, edhe paralajmërime optimiste se kjo çështje shumë e ndjeshme do të zgjidhet, mirëpo edhe ne sot jemi dëshmitarë të asaj se diplomat e universiteteve të Kosovës nuk njihen në Serbi.

Kjo gjendje aktuale për shqiptarët në Luginën e Preshevës është natyrisht cenim i të drejtave elementare të këtyre qytetarëve, cenim i të drejtave elementare të njeriut, sepse që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës të rinjtë të cilët kanë diplomuar në universitetet e Kosovës nuk kanë të drejtë pune në institucionet e Luginës së Preshevës në përgjithësi, ata nuk kanë të drejtë që të punësohen në Serbi dhe ky numër nuk është i paktë.

Moszgjidhja e këtij problemi është shkaku kryesor i mosintegritit të shqiptarëve institucionet shtetërore, në institucionet publike të Serbisë dhe drejtpërdrejtë kjo po e implikon vazhdimin e shpërnguljes masovike të të rinjve shqiptarë nga ky rajon, e cila ka filluar qysh në vitin '91 dhe ka vazhduar deri në vitin 2001, kur fillimisht është krijuar edhe si problem i rëndë i mosnjohjes së diplomave në Serbi.

Përpos mosnjohjes së diplomave universitare të Kosovës, shkaktar tjetër, madje esencial, për mosintegrimin e shqiptarëve në institucionet shtetërore të Serbisë patjetër është edhe mosgatishmëria politike e nivelit qendror shtetëror në Serbi për ta realizuar një pjesëmarrje substanciale të shqiptarëve në institucionet shtetërore dhe në ato publike. Andaj, pjesëmarrja e shqiptarëve në organet shtetërore dhe publike, si në nivelin lokal dhe në nivelin rajonal...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Në kuadër të këtij debati ngritët një pyetje si çështje legjitime, se cilës qeveri ne po i drejtohem i me këtë debat, respektivisht me këtë projekt-rezolutë.

A po i drejtohem i Qeverisë së Shqipërisë, e cila e ka në Kushtetutë mbrojtjen e shqiptarëve jashtë territorit të saj? A po i drejtohem i Qeverisë së Serbisë, një shteti armik ndaj shqiptarëve atje dhe këtu? Apo po i drejtohem i Qeverisë së Kosovës që nuk e ka të përfshirë as në Kushtetutën e saj në asnjë shkronjë mbrojtjen e interesave të shqiptarëve jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Madje, thënë që si mund t'i mbrojnë interesat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc një shtet, respektivisht disa qeveri të cilat nuk i mbrojnë interesat e shqiptarëve as këtu në Kosovë. interesat e shqiptarëve në Kosovë nuk janë, as të përshkruara, as të mbrojtura, brenda territorit të Republikës së Kosovës e i mbajmë me shpresë shqiptarët jashtë kësaj republike që ne po i mbrojmë interesat e tyre kombëtare.

Kur bëhet fjalë për identitetin kombëtar, si mundet ky shtet ta ndërrojë identitetin kombëtar nga i cili ka hequr dorë vet? Si mund ta mbrojnë ky shtet dhe kjo Qeveri flamurin kombëtar shqiptar, nga i cili ka hequr dorë vet? Andaj, ju lutem, keni kujdes se çfarë po e ngarkoni një qeverie që, as s'ka mundësi e as s'ke vullnet t'i mbrojnë këto interesa të shqiptarëve atje.

Por, me çështjen e pazgjidhur të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc është manipuluar shpeshherë, siç po ndodh edhe tani, jashtë këtij parlamenti, s'po mendoj te deputetët, ku çështja e shqiptarëve në Preshevë dhe në Medvegjë e Bujanoc përdoret e keqpërdoret sa herë që ne i japim koncesione Serbisë në marrëveshje me ta. Përderisa asnjëherë në kontaktet, bisedimet apo negociatat me Serbinë çështja e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc nuk ka qenë çështje në tavolinën në mes bashkëbiseduesve dhe bashkënegociatorëve. Pra, ne sot e kemi po ashtu në dorë edhe një projekt-rezolutë të ardhur nga Thaçi, që prapë më duhet ta them, është mashtrim i radhës. Madje, edhe kontrabandë mund ta quajmë, sepse na ka ardhur në tavolinat e deputetëve.

Një nga kolegët këtu të mitë, po më thotë pse po e përmend atë rezolutë? Por, na ka ardhur në tavolinë, qoftë në mënyrë kontrabanduese, qoftë në mënyrë të ligjshme, qoftë në mënyrë të paligjshme, siç e kam unë në tavolinë e ke edhe ti, zotëri. Prandaj, unë dua ta refuzoj. Zoti Bilall, prandaj unë dua ta refuzoj një qasje të tillë dhe një keqpërdorim të radhës të çështjes së shqiptarëve Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Krejt çfarë mund të bëjmë ne si përfaqësues të drejtpërdrejtë të qytetarëve është që të kërkojmë nga Republika e Shqipërisë që ta zbatojë Kushtetutën e saj. Edhe unë pra si një adresë të vetme mbetet që të kërkoj nga Republika e Shqipërisë që ta zbatojë Kushtetutën e saj. Këtë kërkesë nuk mund t'ia adresoj Serbisë, sepse kurrë nuk do të duhet ne të bëjmë kërkesa ndaj një shteti armik ndaj shqiptarëve atje dhe këtu. Këtë kërkesë nuk mund t'ia drejtoj Qeverisë së Kosovës, sepse

nuk e ka të përshkruar në kompetencat e saj, as në Kushtetutën e saj. Prandaj, shpresojmë që Qeveria e Shqipërisë do të marrë masa në zbatim të Kushtetutës.

Vëllezërve shqiptarë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, të cilët i përshëndes dhe inkurajoj që të qëndrojnë dhe të organizohen, ju them që të mbështeten fort në popullin shqiptar të Kosovës e jo në shtetin dhe Qeverinë e Kosovës, e cila i ka braktisur, sidomos tash e 20 vjet pas luftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryesues,

Të nderuar qytetarë,

Në veçanti të nderuar qytetarë shqiptarë të komunave për të cilat sot po flasim këtu,

Këtu mund të bëjmë shumë fjalë, mund të thurim shumë fjali të bukura dhe në fund të ditës të miratojmë një rezolutë, për të cilën pastaj duhet të presim muaj apo vite dhe në fund të përfundojmë me konstatimin se nuk është zbatuar edhe kjo, siç nuk janë zbatuar të gjitha të tjerat, sepse nuk besoj që hallet e tyre i zgjidhim duke zbatuar rezoluta, por duke marrë një vendim të thjeshtë. Nga shtatë milionë buxhet që kanë dy shtetet, shtatë miliardë dy shtetet, Shqipëria dhe Kosova, në proporcion me siç ndahet buxheti për kokë banori të ndajmë edhe për komunat tona. Pra, pa qenë formalisht brenda Kosovës t'i trajtojmë si komuna të Kosovës dhe Shqipërisë dhe të ndajmë buxhet për ta. Pra, të ndajmë buxhet siç ndajmë për çdo komunë të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës.

Mos më thoni se është e pamundur linja buxhetore të bëhet, sepse ka 100 forma se si paratë mund të ndahen pa u quajtur linjë buxhetore. E pash që është keqpërdorur mendimi i shprehur përmes deputetes Balaj-Halimaj për ministri. Pse jo? Ama, jo shtesë ministri. Le të hiqen tri a katër ministri tjera, por le të bëhet ministria për Luginën e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Pse jo? le të hiqen tri-katër të tjera, të cilat të gjithë e dimë që ka nga ato që mund fare të mos jenë dhe nuk do të prishnin punë.

Pra, dy gjëra janë: gatishmëri për të krijuar një institucion që merret drejtpërdrejtë me atë çështje edhe të ndahen paratë, të ndahet buxhet. Të jeni të sigurt, që vetëm në atë mënyrë ne do të mund të mbajmë njeriun tonë atje, nëse mendojmë se është interes yni strategjik. Besoni që krejt ky ndikim i Serbisë në komunat veriore po bëhet me deklarata me rezoluta, jo. Me qindra miliona euro që ajo i ndan, paguan paga për arsimtarë, paguan paga për gjykatës, paguan paga për administratë, për prokurorë e për të gjithë ata që thotë se nuk i ka të vendosur në Kosovë, por i ka të vendosur në veri, i ka të vendosur në Leskovc, në Nish e ku ta di unë.

Pra, ajo është duke e ushtruar ndikimin e saj në Kosovë vetëm përmes ndarjes së parave të mëdha të rregullta, të mos flasim për ato kontrabandë e të mos flasim për ato të krimin të organizuar, për të cilat nuk dua të flas në këtë seancë, po të gjithë e dimë. Nëse e kemi seriozisht që të ndihmojmë në mbajtjen e njeriut tonë atje, përpos gjërave të mira që u thanë këtu, përpos ushtrimit të ndikimit përmes institucioneve ndërkombëtare, që Serbia të ndalë këtë formë të represionit, sepse ky është një formë represioni tash të quajtur “terror i bardhë”. Terror i bardhë - ti nuk e sheh gjakun, nuk derdhet gjaku, sepse largohen njerëzit.

Nëse e kemi seriozisht vetëm në këtë mënyrë mund të ndikojmë që njerëzit, shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës e Bujanocit të ndalen atje. Pse po besojmë ne që ata do të shkojnë atje, do të vijnë të kryejnë fakultetin këtu edhe të shkojnë atje për të punuar, nëse ajo diplomë nuk u njihet? Kush? Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës dhe ku janë institucionet ndërkombëtare që nuk ushtrojnë presion për t’u pranua ato diploma? Të jeni të sigurt se në momentin kur t’u pranohen diplomat edhe atje njerëzit do të mund të kthehen për t’u punësuar. Nëse ky referendum i bojkotuar nga shqiptarët nuk njihet si referendum i bojkotuar dhe rrjedhimisht edhe rezultatet e papranueshme nga bashkësia ndërkombëtare, nga Bashkimi Evropian në veçanti, atëherë sigurisht se pasojat që i ka shkaktuar ky vendim do t’i vuajnë qytetarët e Luginës atje.

Pra, le të kuptohemi, qëllimet arrihen duke ndarë buxhet, qëllimet arrihen duke krijuar infrastrukturë institucionale, që të merret në mënyrë specifike dhe vetëm me atë çështje. Përndryshe, do të vazhdojmë t’i radhisim rezolutë pas rezolute dhe përderisa ne këtu flasim, jo vetëm se nuk zgjidhet problemi atje, por do të vazhdojë të thellohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Nuk është kohë e largët për ta kujtuar dhe për ta ditur se çfarë do të thotë të jesh shqiptar nën administrimin serb, shtet që kultivon gjithnjë urrejtje, që prodhon shovinizëm ndaj shqiptarëve dhe e dini që çfarë mësojnë nxënësit serbë edhe sot në Kosovë. Ata vazhdimisht mësojnë se në këtë vend jetojnë shqiptarët, të cilët kanë qasje primitive edhe ndaj objekteve të kultit, të fesë, e tjera, gjëra të cilat i nxit në mënyrën më të keqe vetë shteti serb dhe kjo para syve të misionarëve ndërkombëtarë. Madje, Serbia i ka përqaftuar edhe konventat ndërkombëtare për respektim të të drejtave të njeriut, ku garantohet e drejta secilit, pa dallime etnie. E drejta në shkollim, e drejta në pronë, e drejta në përdorim të gjuhës, dhe çdo gjë tjetër, të cilën e njohin standardet ndërkombëtare.

Ne jemi dëshmitarë sesi Serbia, për llogari hegjemone i përdor edhe serbët që jetojnë në Kosovë, duke shkelur të drejtat e tyre. Siç e dini, për ditë e më shumë po shtohen ankesat e tyre se ata edhe kur votojnë, nuk votojnë lirshëm, ngase del një rezultat i fabrikuar.

Komisioni i të Drejtave të Njeriut ka pranuar një ankesë edhe të punëtorëve të Ranillugut, të cilët largohen padrejtësisht nga puna për t'u rekrutuar njerëz servilë të pushtetit, të cilët kanë mision trazimin e vendit.

Kësaj politike agresive mund t'i vë digë vetëm një Kosovë e zhvilluar. Dhe rajoni në përgjithësi, i cili duke ngritur standardin e jetës, natyrisht se obligon secilit për ta bërë këtë. Edhe në rezolutën e vitit 2013, kemi folur për një fond zhvillimor, për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin. Këtë gjë mund ta bëjë Kosova, mund t'u rri detyrave të veta, nëse vërtet është një vend i zhvilluar për veten, dhe pastaj mund të reflektojë për të tjerët. Në formën sesi po reflekton ajo në qeverisjen e vet, pak lë për të dëshiruar se mund të bëjmë më tepër.

Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Bruksel shumë marrëveshje, të cilat Serbia vazhdon t'i shkelë. Pse lejohet kjo? Nëse këto marrëveshje nënshkruhen në vendin ku flitet për demokracinë, pra në Bruksel, atëherë nuk do të duhej të lejohej një gjë e tillë. A janë standarde të njëjta të të drejtave të njeriut, apo ka dallime? A po lejohet Serbia nëpër kohë që të jetë trazuesja e Ballkanit dhe më gjerë, siç edhe e ka dëshmuar koha. Vetëm primitivëve u pengojnë njerëzit e arsimuar, injorimi i diplomave apo mosnjohja, problemi me tekstet shkollore. Për ditë e më shumë nga atje raportohet se edhe bibliotekat të cilat kishin dikur një fond librar që u shërbente njerëzve, ato janë të zbrazura dhe nuk dihet fati i atyre librave, se kah hudhen, apo edhe ndoshta zhduken të tëra.

Me politikën sistematike asimiluese, Serbia ka tjetërsuar edhe shqiptarët e Sanxhakut, ka shpërngulur edhe krahina të tëra dhe edhe në këto njëzet vjet të fundit, ka ndodhur edhe një Toplicë e dytë. Po vazhdon me pjesën e mbetur, me shlyerjen apo siç e quajnë ata pasivizimin e adresave, shlyerje nga regjistri civil të shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës e të Bujanocit.

Papunësia shkon mbi 70 për qind, vetëm për të bërë trysinë që askush mos të shohë perspektivën në këtë vend dhe të gjejë rrugë të tjera, siç për fat të keq edhe ka ikje të vazhdueshme nga atje. E këtë boshllëk nuk mundohet ta mbushë edhe fondet ndërkombëtare, fondet e IPA-s dhe fondet e tjera, të cilat, të zgjedhurit shqiptarë atje në nivelet lokale, por edhe qendror që është një deputet, deklarohet se nuk ndahen njësoj. Dhe fondet e tilla të BE-së ndoshta do ta tregonin kujdesin më të madh që diskriminimet e tilla për ata që disonojnë në demokraci t'i përmbushë me kujdesin më të shtuar, por kjo nuk po jep rezultate inkurajuese.

Kur bota e sheh ndryshe këtë rajon, ashtu do ta shohë edhe Serbia, do ta obligojë në një rrugë të tillë, ngase do të detyrohet të flasë me gjuhën e civilizimit, të cilën e kërkojnë këto standarde.

Pikat e rezolutës, pa dashur ndoshta secili t'i përsërit, tash duke i rikujtuar edhe ato të vitit 2013, janë në interes, me interes jetik për shqiptarët atje, por ato marrin jetë vetëm kur edhe ne jemi seriozë me vetveten për të lënë mundësi për të ndihmuar edhe për shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë!

Riaktualizimi i gjendjes në të cilën janë komunat e Luginës përmes kësaj seance të jashtëzakonshme duhet të jetë si shkas i mobilizimit serioz të Kosovës dhe Shqipërisë, në përpjekje të përkrahjes jo vetëm me premtime boshe, por duke ndërtuar edhe veprime konkrete për çështjet e të drejtave të shqiptarëve të cilët jetojnë në Luginë.

Përveç fushës ekonomike, situata në të cilën gjendet arsimi fillor dhe i mesëm në këto treva, pasi që ai i lartë është i paqasshëm për shqiptarët, është e mjerueshme, sepse ambienti në të cilin e ka krijuar Qeveria serbe në këtë pjesë përmes censurimit ligjor, duke ua pamundësuar qasjen në tekstet shkollore shqiptare të nxënësve e bën tejet të vështirë mësimnxënien dhe shkollimin e mëtejshëm për të rinjtë e Luginës. E në fakt, në vendin tonë minoriteti serb si dhe minoritetet e tjera siç është ai goran në Komunën e Dragashit punojnë me planprogramin e Serbisë dhe financohen nga shteti serb. Pra, kanë një sistem paralel në vendin tonë. Kjo dukuri jo që nuk u ndalua, por përkundrazi u përkrah nga Qeveria jonë.

Çka mbetet tejet shqetësuese dhe e padrejtë, është pamundësia dhe nostrifikimi apo njohjet e diplomave për shtetin serb, të të rinjve të Luginës, të cilët kanë studiuar në Kosovë dhe në Shqipëri. Përkundër faktit, kjo e drejtë është dashur të respektohet, sepse Kosova dhe Serbia kishin pasur një marrëveshje paraprake në Bruksel për njohjen e ndërsjellë të diplomave të vendeve të tyre për qytetarët e të dyja vendeve. Kjo d.m.th. ka qenë një ndër marrëveshjet, e 33 marrëveshjeve, të cilat i konsiderojmë si jomarrëveshje, se të cilat asnjëherë nuk janë realizuar.

Krerët tanë institucionalë, duke filluar nga Hashim Thaçi, i cili deklaronte se Serbia de fakto na njohu dhe sipas tij Serbia na ka njohur jo vetëm një herë, por 33 herë, sipas atyre 33 marrëveshjeve. Dialogu Kosovë- Serbi, si një proces i drejtuar nga z. Thaçi asnjëherë të vetme nuk arriti që përpara Bashkimit Evropian të mbronte interesat dhe të drejtat e shqiptarëve të Luginës, kurse kohëve të fundit, me shfaqjen e disa temave, të cilat për nga substanca janë mjaft edhe të rrezikshme.

Është momenti i fundit që përpjekjet tona si Kosovë dhe Shqipëri të jenë serioze në angazhimin tonë, që përmes politikave adekuate dhe të qëlluara, të ndryshojmë pozitën e bashkëkombësve tanë në Luginë, duke i sensibilizuar Bashkimin Evropian dhe vendet tona mike anekënd botës, që përmes trysnisë të cilën do të ushtrojnë ndaj shtetit serb, duke e detyruar për respektimin e lirive

dhe të drejtave të pakicave, t'i ndihmojmë që ajo pjesë të krijojnë kushtet për një jetë normale të qytetarëve tanë, duke iu garantuar të drejtat të cilat garantohen të drejtat në të gjitha konventat ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE DALIPI-PACOLLI: Faleminderit!

Nga janari 2014 kur Serbia edhe zyrtarisht ka filluar negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, raportet e Bashkimit Evropian deri më sot, nga raportet e Bashkimit Evropian e dokumentet e tjera, deri më sot e shohim se nuk ka pasur asnjë përmirësim. Sa i përket gjendjes ekonomike dhe mirëqenies së shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Në një analizë të thjeshtë të raporteve të progresit të vitit 2014, 2014 dhe 2016, dhe raporteve për vendin 2018, 2019, për Serbinë dhe Kosovën, shihet qartë se Bashkimi Evropian po vazhdon të zbatojë një qasje asimetrike për të drejtat e minoriteteve në Ballkan, e sidomos në relacion me shqiptarët.

Qasja e BE-së në Serbi duhet të jetë e njëjtë sikurse qasja e tyre që kanë në raport me Kosovën dhe në raport me komunitetin serb në Kosovë. P.sh. në raportet e vitit 2014, 2015 dhe 2016, ka nga një paragraf për gjendjen e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, po një paragraf i tillë nuk përfshihet më në raportin 2018 dhe 2019. P.sh. në raportin e Komisionit Evropian për vendin, për Kosovë, komunitetit serb i kushtohet pesëfish më shumë vëmendje sesa komunitetit shqiptar në raportin për Serbinë, ku fjala shqiptar përdoret vetëm dy herë.

Çështjet e vetme për shqiptarë që ngrihen në raportin për Serbinë 2019 janë çështja e teksteve në faqen 25, pra ku thuhet ka pasur rezultate pozitive, janë publikuar pesë tekste shtesë në gjuhën shqipe, mirëpo ende nuk janë përgatitur tekste për shkollat e mesme. Në faqe 68 ku tregon se nga viti 2018, Radiotelevizioni publik i Serbisë ka lejuar transmetimin e lajmeve në gjuhën shqipe, të cilin e quan si hapin e parë për përmbushjen e obligimeve që Serbia obligohet të prodhojë dhe të transmetojë përmbajtje programore për minoritetet kombëtare. Dhe kjo është vetëm pesë minuta. Pra, lejohet transmetimi i lajmeve në gjuhën shqipe.

E tërë situata dhe gjendja e rëndë e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc, e Medvegjë përfshihet vetëm me një fjali. Pra, në raportin për vitin 2019 dhe thotë se minoritetet kombëtare mbeten të nënpërfaqësuar në institucionet publike.

Niveli i ulët i punësimit të shqiptarëve në institucionet publike, përkeqësimi i gjendjes së tyre ekonomike, varfëria dhe niveli i lartë i papunësisë nuk përmendet askund në këtë raport. Nuk përmendet as sistemi i centralizuar në Serbi që ka bërë në administratën tatimore, pra e cila është

zhvendosur në Vranjë, kurse në Bujanoc dhe Preshevë kanë mbetur vetëm punëtorët e thjeshtë, siç është rasti i punëtorëve të arkivit.

Gjithashtu, kohë më parë është larguar edhe Dogana nga Presheva, kurse sipas paralajmërimeve, nga 1 janari, edhe shtëpia e shëndetit do të kalojë në kompetenca të qeverisë, që do të thotë se edhe drejtori i shtëpisë së shëndetit do të emërohet nga Ministria e Shëndetësisë, e jo nga Kuvendi Komunal që ka qenë deri më sot.

Kjo përbën një diskriminim shtetëror ndaj komunave të banuara me shqiptarë, që përkundër insistimit tonë të vazhdueshëm, vazhdon të punësojë serbë në organet shtetërore në institucionet publike dhe joshqiptarë në këto komuna.

Raporti nuk thekson se në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë ka prezencë të lartë të ushtrisë, policisë dhe përfshirë bazën ushtarake të Serbisë, e cila ende shkakton një ndjenjë të frikës dhe ndjenja e diskriminimit dhe izolimit është shumë e thellë. Pra, kaq i kushton rëndësi raporti i progresit dhe raporti për vendin i Bashkimit Evropian për Serbinë dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Serbi dhe këtu është problem qasja që ka pasur Kosova, shteti i Kosovës dhe shteti shqiptar sa i përket përfaqësimit të shqiptarëve në Bashkimin Evropian.

Unë kam edhe dy propozime që mendoj se duhet të futen në rezolutë. Propozimi i parë është që të kemi një fond të veçantë për studentët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës. Po e jap një shembull të thjeshtë. Pra në një familje me kushte ekonomike mesatare, pra një familje e zakonshme, në Bujanoc, Preshevë, apo Medvegjë, nëse ka gjashtë anëtarë dhe një pagë mesatare 300 euro, e cila do të detyrohej që përveçse të mbajë anëtarët e familjes, ka edhe student në Kosovë, atëherë shpenzimet mesatare të një studenti në Prishtinë arrijnë vlerën 1500 euro në vit. Po flas për shpenzime minimale, pra pagesën e semestrit, konviktin, dhe transportin. Po nëse marrim shembull, nëse studentit studion art apo ndonjë drejtim tjetër, që i duhen më shumë shpenzime, si ngjyra, pëlhurë apo shpenzime të tjera, atëherë familja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një minutë i ke.

FITORE PACOLLI: Atëherë, studentët të cilët studiojnë në drejtim të tjera, ku duhen shpenzime shtesë, familjet dhe këta studentë do ta kenë të vështirë të sigurojnë fonde që i nevojiten.

Një fond i ndarë nga Qeveria e Kosovës për studentët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja do t'i ndihmonte shumë këto familje dhe këta studentë.

Po ashtu e kam një informatë se nxënësit nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja kërkohet që të bëjnë nostrifikimin e diplomave të tyre që marrin nga shkollat e mesme në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Atëherë, nëse është kjo e vërtet, duhet që këta nxënës të largohen nga pagesa e nostrifikimit të diplomave, sepse kjo është një shumë e shtuar që bie mbi barrën e secilës familje që i dërgon fëmijët e tyre për studime këtu në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Rezoluta e kaluar ka qenë ajo e dt. 6 qershor 2013. Kjo rezolutë u pat miratuar pas një debati, e ky debat u pat bërë pasi që u pat kryer marrëveshja e prillit 2013. Para se të bëhej kjo marrëveshje, kanë qenë negociatat. Gjatë negociatave ka pasur edhe demonstrata. Ka pasur heqje të lapidarit. Ka pasur kërkesa të vazhdueshme dhe premtime se do të diskutohet për shqiptarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në ato negociata. Asnjëherë, asnjë fjalë. Dhe pasi u krye krejt, pra u pat bërë edhe marrëveshja, pa u folur fare për shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, për ta mbuluar diqysh krejt këtë farë turpi, u pat mbajtur ky debat dhe i cili e pat sjellë një rezolutë, e cila rezolutë asnjëherë nuk është jetësuar.

Kjo rezolutë është sjellë në kohën kur ka qenë kryeministër, Hashim Thaçi. Atëherë ka qenë edhe një premtim. Edhe pra s'u bë pra kurrëgjë gjatë negociatave. Atëherë të hapet një zyrë. As ajo zyrë asnjëherë nuk është funksionalizuar. Po nuk është çështja që është dashur zyrë. Është dashur shumë më tepër. Është dashur që gjatë tërë kësaj kohe sa kemi negociuar ne me Serbinë, ta shtrojmë këtë çështje, ta kemi temë në tavolinë dhe ta kemi si kusht edhe para negociatave. Asnjëherë nuk është bërë një gjë e tillë.

Prandaj, qytetarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës me të drejtë janë të zhgënjyer. Janë të zhgënjyer dhe janë të pashpresë që diçka mund të vjen ndonjë mirë nga Prishtina, pikërisht për faktin se Prishtina ka pasur mundësinë. Ka pasur mundësinë sepse ka shkuar në negociata dhe Serbia ka qenë e varur prej këtyre negociatave, dhe vazhdon të jetë e varur prej negociatave me Kosovën. Dhe çka ndodh atje në ndërkohë, vazhdon ai diskriminim i vazhdueshëm. Edhe brenda Serbisë, shqiptarët janë komuniteti më i diskriminuar se të gjitha komunitetet e tjera, sepse të gjitha komunitetet e tjera kanë shtete amë që përkujdesen për ta, ndërkohë që për shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës nuk përkujdeset askush. Janë premtime të shumta dhe janë marrëveshje madje të shumta që do të ndahet edhe buxhet në fushën e lëmisë së kulturës dhe sportit, po nuk është bërë asnjëherë.

Ai pak buxhet është dashur që të arrijë disi përmes Republikës së Shqipërisë dhe ajo një pjesë e vogël që deri më tani, tek sa ka arritur atje, tek pas një viti vonesë, ku në vend që edhe Tirana të jetë shumë më aktive, më proaktive drejt mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe investimit në

përmirësimin e jetës së tyre, edhe ata në vend që ta kryejnë punën dhe të investimet që vijnë nga Kosova, ata e vonojnë atë për një vit.

U thanë këtu kritika të shumta. U përshkrua gjendja e qytetarëve në Preshevë. E kemi thënë në vazhdimësi më herët dhe të gjithë e kemi të qartë se çka. Nuk mjaftojnë debatet, nuk mjafton rezoluta. Ato duhet të bëhen gjithmonë, po nuk mjaftojnë si të tilla. Duhet të kalohet në punë konkrete. Hap i parë konkret është që ne duhet ta kemi të qartë që nuk duhet të vazhdojmë negociatën me Serbinë, në të cilat nuk vendoset në tryezë çështja e të drejtave të shqiptarëve të Preshevës, të Bujanocit e Medvegjës. Nuk duhet të bëjmë ndonjë delegacion në të cilin nuk bën pjesë dikush, një përfaqësues nga Lugina.

Po ashtu, duhet ta kemi të qartë që kjo puna e njëjtë që është bërë tash me këtë delegacionin që shkoi edhe bëri një vizitë, e njëjta duhet të bëhet edhe me një delegacion tjetër i cili duhet ta vizitojë Sanxhakun. Të mos harrojmë që në një të shkuar jo shumë të largët, edhe Sanxhaku, edhe Presheva, Bujanoci e Medvegja kanë qenë në një vilajet me Kosovën, kanë qenë të lidhura ekonomikisht dhe kulturalisht me njëra-tjetrën. Këto janë shkëputur, natyrisht padrejtësisht me kufij të shumtë që janë vizituar ndërmjet, edhe Kumanova prej Preshevës, edhe Rozhaja prej Novi Pazarit e të gjitha këto nga Kosova.

Po, çka duhet bërë tani? Tani duhet që gjithmonë në negociatat tona karshi Serbisë ta kemi parasysh këtë. Duhet të mos harrojmë që në jetën tonë të përditshme duhet të jetë përherë e pranishme Lugina e Preshevës, Presheva, Medvegja, Bujanoci edhe Sanxhaku. Duhet ta dimë që në ekipet tona, në ligat tona sportive të jenë edhe ekipet nga Presheva, Bujanoci e Medvegja. Të kemi mundësinë që ne prej këtu të ndikojmë në jetën kulturore atje paralelisht me punën që do ta bëjmë duke e kushtëzuar Serbinë në negociatat që do të ulemi me ta.

Nëse nuk e kemi parasysh gjithmonë atë rezolutë, atë vendim që e kanë nxjerrë këshilltarët, jashtëzakonisht rezolutë e drejtë, ku bëhet fjalë për reciprocitet të të drejtave të shqiptarëve deri në shkëputje, nuk kemi bërë asgjë. Dhe po ashtu edhe referendumin e vitit 1992. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për të mos u keqkuptuar, dua t'ju them që sa i përket Shqipërisë, niveli më i lartë i shtetit shqiptar, ka vizituar Preshevën, Medvegjën e Bujanocin. Presidenti i Shqipërisë, Kryeministri i Shqipërisë, deputetë të Kosovës. sa kanë arritur të bëjnë për Preshevën, Medvegjën e Bujanocin, është diçka krejt tjetër. Po ne nganjëherë po flasim shumë, edhe mundësitë tona i dimë. I dimë kompetencat tona, i dimë rregullat. Ne nuk mund të shkojmë akoma të kalojmë kufirin e Kosovës në drejtim të Serbisë me targa të rregullta të Kosovës. Prandaj, edhe kur flasim se çka duhet të bëjmë për atë, duhet ta kemi parasysh. Adresimi më i mirë, me argumente është t'i drejtohem edhe Bashkimit Evropian, edhe ambasadave që janë këtu, edhe fondacioneve të ndryshme që financojnë arsimin, kulturën, shkencën, vendet dhe regjionet.

Ata, për kushtet e sotme, unë s'po them për pretendimet që ka njëra ose tjetra palë, po është një mekanizëm i regjioneve në Evropë, i cili ka mjete dhe ka angazhime regjionale, e në këtë rast do të thosha, që sikur edhe Presheva, Medvegja dhe Bujanoci do të pretendonin që të anëtarësohen në këtë mekanizëm përfaqësues të regjioneve të Evropës që kanë situata të ngjashme, siç ka Presheva, Medvegja e Bujanoci, njëjtë po besoj që do të kishin përfitime më të mëdha.

Unë, nganjëherë kur të flasim fjalë të mëdha, unë dua t'ju them që duke dashur t'u ndihmojmë, ne i dëmtojmë ata më shumë, sepse edhe akuzat në drejtim të nesh, nga ata që s'duhet t'i kemi, i kemi të tilla çfarë i kemi.

Prandaj po them që mirë që ndodhi debati, por mendoj që duhet t'i shtrijmë këmbët sa na mbërrin jorgani dhe jo ta kalojmë, se pastaj nuk arrijmë kurrëgjë të bëjmë.

Shumë herë është mirë që të kemi edhe debate, jo për kamera, jo për elektorat. Edhe për këtë rast, unë mendoj që më mirë kishte qenë të jetë debati i mbyllur dhe të diskutojmë realisht për situatën që e kemi ne, situatën që e kanë ata dhe sa mund ta ndihmojmë ne Preshevën, Medvegjën e Bujanocin dhe cilat janë obligimet tona.

Unë nuk e di, më duket se ka pasur një marrëveshje me Serbinë për pranimin e diplomave. Po edhe në qoftë se s'ka pasur, ne duhet të kërkojmë që ata t'i pranojnë diplomat. Pra, mos harroni që ne kemi plot Kosovën me nga tri diploma dhe janë të papunë. Edhe s'janë nga Presheva asnjëri, po janë nga Kosova këtu.

Kriza ekonomike në rajon është e tillë, edhe në Kosovë është e tillë. Prandaj, debati ka qenë i mirë. po besoj që do të kemi kujdes që edhe në marrëveshjet që i bëjmë, këtu, jo sa i përket rezolutave, po edhe për drejtim të seancës, se pat reagime, ta ngremë zërin në kohë, pa u marr vendimi, pa filluar, pa u proceduar, pa filluar procesi. Nuk mund ta lëmë dikujt t'i jepen pesë minuta, dikujt dhjetë minuta.

z. Sami Kurteshi, s'ta përmenda emrin. Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

Atëherë s'do Samia të flasë.

Jo, jo, unë e kam në rregull punën. Unë qysh ma ka lënë Kryetari, e kam vazhduar. Mirë e çlirua Preshevën.

Zoti Sami Kurteshi, a e do fjalën a s'e do?

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Se ne e kemi degraduar Kuvendin në një vend të kriminalizuar. Këtu është marrë vendim të shkurtohet diskutimi pesë minuta, kurse ne e kemi një Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës me dy të tretat të votuar, ku diskutimi është dhjetë minuta. Edhe secili ka të drejtë diskutimin e vet ta shkurtoj. Unë nuk e di kush ka marrë vendim të shkurtohet diskutimi pesë minuta. Kjo është kundërligjore. Po ky është kriminalizimi, po nejse.

U fol shumë për diskriminim individual e kolektive të shqiptarëve atje, edhe për cenimin e të drejtave të njeriut në Luginën e Preshevës. Tani, është krijuar një situatë me njerëzit tanë të Luginës së Preshevës, që njihet vetëm para Luftës së Dytë Botërore, mohimi i të drejtës për të pasur të drejtë që e përshkruan edhe Hana Arendi, për hebrenjtë.

Gjermania naziste i shlyen hebrenjtë nga shtetësia, kurse shtet tjera nuk ua pranojnë të drejtën, ata janë njerëz pa shtetësi dhe pa të drejta. Kjo është duke ngjarë me bashkatdhetarët tanë, me njerëzit tanë në Luginën e Preshevës, edhe këtë kompetencë nuk e paska Republika e Kosovës. Ka arsye të ndryshme që të thuhet kjo.

Ne duhet t'i pranojmë faktet, cila është politika e Qeverisë serbe ndaj shqiptarëve. Një e vërtetë është e pamohueshme; shteti serb është shtet i ngritur mbi gjenocidin, mbi spastrimin etnik, mbi krimet e luftës dhe mbi krimet të njerëzimit.

Përveç pashallëkut të Beogradit, të gjitha pjesët e Serbisë janë pjesë të okupuara me këto karakteristika.

Sjellja e Qeverisë dhe e politikës serbe ndaj fqinjëve nuk ka ndryshuar tani e dy shekuj. Ajo është edhe hegjemoniste edhe gllabëruese. Prandaj, të gjitha veprimet shkojnë në këtë drejtim.

Kush e ka dëgjuar dhe e ka përcjellë “skupshtinën” serbe, Kuvendin serb më 27 dhe 28 maj, prej 15 orësh diskutim në Kuvend të Serbisë, 4 orë i ka marrë Vuçiqi me luftën kundër fqinjëve, kundër shqiptarëve, duke i kërcënuar të gjithë fqinjët.

Çdo projeksion që e ka bërë Vuçiqi dhe Kuvendi i Serbisë, qoftë demografik, qoftë politik, qoftë ekonomik, qoftë social e ka një thelb, thelbi është synimi i marrjes së territoreve të fqinjëve edhe sidomos të shqiptarëve.

Synimi është armatimi me armë sulmuese, sikur me avionë modernë luftarak që nuk i nevojiten Serbisë, po i nevojiten vetëm kundër fqinjëve të vegjël e kundër shqiptarëve.

Kërcënimet e drejtpërdrejta ndaj shqiptarëve dhe sidomos ndaj Sanxhakut, kërcënimet ushtarake dhe policore ishin të hapura. Do të thotë, ne nuk mund të presim me qëndrime të tilla të Kosovës,

duke heshtur para hegjemonisë serbe që tua përmirësojë gjendjen e njerëzve tanë në Luginën e Preshevës.

Një veprim që duhet ta ndërmarrë Qeveria e Kosovës, sepse Lugina e Preshevës është pjesë përbërëse, historike, etnike dhe ekonomike e Kosovës, pa marrë parasysh se cila është ndarja sot.

Një veprim që duhet ta bëjmë është që ta ngremë çështjen e humbjes së të drejtave të qytetarëve të shqiptarëve të Luginës së Preshevës nga Qeveria e Serbisë, edhe ky është veprimi më perfid që është duke e bërë ajo.

Qeveria e Kosovës e ka obligim që ata qytetarë t'i stabilizojë, që nuk guxojnë të kthehen në Luginën e Preshevës për shkak të represionit policor dhe ushtarak, e ka për detyrë t'i stabilizojë në Republikën e Kosovës dhe jo t'i lë si tani e 20 vjet, pa dokumente, pa të drejta, pa të drejta qytetare dhe pa asnjë të drejtë tjetër.

Këtë ne duhet ta bëjmë.

Edhe përsërisë po e përsërisë një çështje që ka të bëjë me Rregulloren. Askush në këtë Kuvend, nuk ka të drejtë që të marrë vendime që janë të parapara me ligj dhe me Rregullore për shkurtimin apo zgjatjen e diskutimeve derisa nuk kanë votuar 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Vendimet e tilla janë arbitrare edhe e kriminalizojnë dhe e degradojnë këtë Kuvend siç po bëhet tani.

KRYESUESI: Besoj që ke qenë në sallë Sami, kur është marrë vendimi, edhe ke mundur që të flasësh. Zoti Zyba a e deshe fjalën? Sami, unë nuk e kam marr vendimin dhe as nuk kam votuar.

Të gjitha grupet parlamentare...

SALI ZYBA: A po flisni ju apo unë tash? Se na e ke shkaktuar një gjendje të padëshirueshme këtu.

Jemi duke folur për një situatë tepër të ndjeshme. Për një temë, jo vetëm serioze, po është edhe e vjetër edhe e lashtë.

Fakti që ka ardhur kjo temë kështu, unë dua t'i sqaroj disa gjëra. Kryetari, në emër të dikujt, po jo me Rregullore, kundër Rregullores e censuroi e mohoi i shkurtoi minutat në pesë minuta.

Po flasim për Luginën, për të drejtat themelore të banoreve autokton atje, e nuk po kemi të drejtë ne si deputetë të një shteti të pavarur që të flasim sa është lejuar për Luginën e Preshevës.

Unë e kam këtu një shqetësim tjetër të radhës. Sot, në mënyrë klandestine, nuk e di me lejen e kujt. Këtu i nënshkruar kryetari i Kuvendit, është shërbyer një rezolutë, është kontrabanduar, për faktin kur e mohoi ose e censuroi në pesë minuta, na u shërbye një rezolutë.

Kjo rezolutë duhet të japë shpjegim nga ju kryesues në këtë rast, sesi erdhi kjo e njëjta e cila sapo është protokolluar. Sot, ka ardhur gjoja prej presidentit dhe sot ka ardhur e nënshkruar edhe prej kryetarit të Kuvendit, dhe çfarë forme ka kjo propozim-rezolutë, për faktin se disa grupe të punës janë duke punuar diku.

Kjo është ajo shkelje dhe reagimi ynë i domosdoshëm. Nëse a e ndalon në pesë minuta, ju dolët me një propozim për të diskutuar në mënyrë të fshehtë për Luginën. Domethënë, po e censuroi edhe lirinë e të shprehurit.

Meqenëse kam qenë pjesë aktive për çlirimin e atij territori, Luginës, kam edhe disa obligime që t'i përmendi.

Prej personave që kontrabandohet kjo rezolutë në këtë mënyrë, duke shkelur ligj dhe Rregullore, po i përmendi disa mundësi që kanë mundur ata që të kontribuojnë.

Luftën çlirimtare nuk e kanë mbështetur. Nuk e kanë ndihmuar. Nuk e kanë mbështetur, dhe ushtarët që janë arrestuar në emër të krimeve që i kanë bërë në Kosovës, e pushtetin në Kosovë e kanë në emër të luftës që e kanë bërë në Kosovë.

Bashkëluftëtarët janë dënuar, janë arrestuar në Preshevë për luftën që e kanë bërë në Kosovë. Asnjëherë nuk e kanë ngritur zërin këta. Kanë mundur të dëshmojnë edhe kur u hoq lapidari.

Edhe kur një marrëveshje ka qenë e garantuar prej dikujt, nuk janë mbështetur prej këtyre personave, dhe sot edhe të drejtën e fjalës ose ta kontrabandojnë një letër ose ta marrin të drejtën që të flasësh.

Unë krejt çka kam përgatitur që të flas, nuk mund të flas për pesë minuta. Andaj, shqetësimet e radhës ishin këto. Ju si kryesues duhet të deklaroheni se pse na është shërbyer një rezolutë për të cilën janë disa grupe të punës duke punuar për një rezolutë që vjen në shprehje.

KRYESUESI: Sa vjet i ke ti? Uroj që të mësosh më shumë se çfarë ka ndodhur përpara. Po, nuk kemi nevojë që të shtyhem këtu se kush ka kontribuar më shumë. Jemi në Kuvendin e Kosovës. I kemi 20 vite pas luftës. Historinë do ta shkruajnë mirë ashtu siç duhet, ata që do ta shkruajnë.

Nuk jemi ne shkruar të historisë dhe s' duhet ta shkruajmë ne historinë. Kështu që, nuk po dua që të ndërhyj. Unë as s'kam shpërndarë rezoluta, as nuk kam shkruar rezoluta. Nuk di unë. Unë s' merrem me atë punë.

Po, mirë de. I keni aty, shikojeni. Komisioni mund ta ketë aprovuar, mund të mos i ketë aprovuar. Tash flet Ismajli. Zoti Kurteshi, mirë se erdhët. Zoti Krasniqi, a jeni paraqitur fjalë? Zoti Krasniqi. Memli, a dëshiron të flasësh.

MEMLI KRASNIQI: A po ia jep fjalën, ta shohim sa vjet i ka bre. S'i m'i pas 100 po duket.

KRYESUESI: A po dëshiron prapë? Jepja fjalën zotit Zyba.

SALI ZYBA: Sa vjet i kam, a po dëshiron ta dish? Një minutë.

KRYESUESI: Dy minuta i ke. Sa të duash fol. Nuk është ndonjë problem.

SALI ZYBA: Gjysma e viteve të mia janë po aq sa fatkeqësia e Kosovës prej se qeverisni ju. 20 vitet e pasluftës, këto dëme që ia keni bërë. Shtoja edhe 20, i kam kaluar në 40-ta. Këto janë vjetët e mia, po janë të shëndosha.

Tuajat, të paktën të 40, të 20 e fundit e janë të krimbura. Janë të rrezikshme për vendin tonë.

KRYESUESI: Unë nuk flas në shumës, po ju them se vitet e mia që janë diku 46 për Kosovën, kurrë s'kanë lëvizur. Kurrë. Edhe kurrë as ti as soji yt as të tjerët s'do të mund ta vënë asnjë njollë.

Propaganda është propagandë. Po ju jeni i ri dhe uroj që të mbetesh patriot kështu siç je. Edhe me biznes edhe me të gjitha të ecin punët mbarë në Kosovë. Faleminderit!

Zoti Krasniqi, e ke fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Ishalla të gjithë nga 100 i bëni. Edhe ishalla keni shëndet. E ishalla kontribuoni për Kosovë edhe më shumë se që keni kontribuar deri më tash. Askush askujt nuk do t'ia mohojë kontributin.

S'kemi nevojë që ta dëgjojmë askënd që të na tregojë sesi e keni çliruar Preshevën, se sikur ta çlironit Preshevën, s'do të ishin ata të shkretë në këtë situatë për të cilën jemi duke folur e si jemi duke folur.

Më duket ishim kah fundi i debatit, po e pashë që deshën ta degjenerojnë me njëfarë paedukate debatin në fund.

Unë e mora një rezolutë edhe po presim një rezolutë prej këtij komisionit që e kanë bërë.

Rezoluta për kërkesat legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës që na është shpërndarë me kërkesën e presidentit, që po thirret këtu në shkresën përcjellëse, mbështetur në nenin 65, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 6, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, nuk jam i sigurt që duhet të diskutohet sot. Por, nëse e keni lexuar tekstin e merreni me procedurën, mua po ma merr mendja që kjo nuk do as diskutim.

Nëse keni rezerva ose kundërshtime me tekstin, përnjëmend është e pakuptimtë. Për procedura mund të flasim. Tekefundit mund të thirret edhe një seancë tjetër e jashtëzakonshme. Pa asnjë problem. Bile ka kompetencë kushtetuese edhe presidenti vet që ta thërrasë.

Mund ta thërrasim edhe ne edhe dalim me këtë tekst. Por, nëse ka dikush problem me përmbajtjen është mirë që të na tregojë, se në bazë të asaj që po e shohë, flitet për kërkesën e shqiptarëve të Luginës që të jenë pjesë e dialogut. Pra, ta kenë një përfaqësues në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Pastaj, Kosova ta ngritë çështjen e shqiptarëve të Luginës në çdo forum ndërkombëtar. Institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë të koordinohen për çështjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Mbi të gjitha të obligohet që respektohet vullneti i shqiptarëve të Luginës për bashkim me Kosovën siç është shprehur në referendumin e '92-ës, e kështu me radhë.

Nuk po më duket që janë pika përjashtuese prej temave të cilat u diskutuan edhe që u propozuan nga rezoluta. A

A keni problem që veç pse sot ka ardhur prej njeriut që e ka ermin Hashim Thaçi dhe që është president i Kosovës? E, këtu është turpi. Këtu është turpi. A po i dëgjoni reagimet. Domethënë, këta e kanë traumë Hashim Thaçin. Kushdo tjetër që do ta sillte, ndoshta do ta diskutonin. Po, prej Hashim Thaçit, as për Kosovë, as për Preshevë, as për Shqipëri dhe as për asgjë.

Këta e kanë harruar bashkimin kombëtar, kur ia ka nisur ai që ta përmend. Bashkimin e Luginës, kur ai ia ka nisur që ta përmend. Pavarësinë e Kosovës, kur ia ka nisur që ta përmend. Tash, ngadalë veç pak, se s'mund ta reduktoni krejt te një individ.

Nëse këto janë pika për të cilat mund të ketë pajtueshmëri, mund t'i marrë komisioni dhe t'i trajtojë. Nëse janë pika për të cilat ka një pajtueshmëri. Nëse jo, tregoni. Nuk ma merr mendja që prish punë. E bëjmë kinse ju e keni bërë këtë, edhe ne ua votojmë.

Mirëpo, të merreni dhe të thoni se procedura nuk është respektuar, se teksti andej-këndeje. Kjo është e pakuptimtë. Sille-pështille, veç e ke të njëjtin send në këtë legjislativë, çka të vjen këtu, thonë pse s'ju ra ndërmend.

Erdhi Tribunali për krime të Serbisë, të njëjtin argument. Pse ju ra ndërmend më herët? Ngadalë veç pak. Nëse s'i ka ra ndërmend, nëse s'u bë diçka më herët, tash s'duhet të bëhet kurrë a po?

Jo, valla s'po e bëjmë s'e s'ju ka ra ndërmend më herët. Po, ja i ka ra ndërmend tani. Pse jeni kundër, more vëlla? Nëse është diçka e mirë, nëse diçka është pozitive, nëse diçka është obligim, tekefundit edhe kombëtar, pse more e keni problem?

Pse duhet të dilni kundër? Jo, është vonë. Po, s'është vonë. Ja, tani nëse doni po e votojmë e pastaj ta shikojmë se a është vonë. Ta obligojmë vetveten edhe të tjerët të flasim për këtë punë. Edhe presidentin. Edhe kryeministrin. Edhe Kuvendin. Eja, po obligohemi. Eja, po obligohemi e pastaj po shikojmë se kush po e kryen punën.

Domethënë se veç duhet të bëhet muhabet këtu. Të dilet të tregohet patriotizëm. Të dilet të akuzohet. Të etiketohet edhe të mbahet shpresë që kurrë s'do të bëhet asgjë. Kjo është logjika.

Nuk po ju them unë që sot ta fusim në votim, por nëse nuk e trajton ky komision një propozim që vjen prej kreut të shtetit, edhe këta duhet ta tregojnë arsyen se pse.

E dyta, s'ka asnjë problem. Mund ta bëjmë një seancë tjetër të jashtëzakonshme. Le të sillen kjo farë rezolute për kërkesat legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, kështu e paska titullin, edhe flasim.

Po, unë mësa e di ishte duke u kryer debati. Nëse doni ne kështu e nxisim edhe kah 15 minuta edhe 7-8 veta edhe rrimë edhe në fund s'ka deputetë që të votohet asnjë rezolutë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne u futem në një temë tjetër. Tani fjalën për replikë e ka... Po, i je drejtuar. Është nënkuptuar që po u drejtohesh atyre dhe ka replikë zoti Liburn Aliu. E drejtë e tij është.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Ne e morëm këtë rezolutë dhe kjo rezolutë thirret në rezolutën e 6 qershorit 2013.

Për sa i përket tekstit këtu brenda, as që kemi hyrë në shqyrtim, sepse kemi komision dhe të gjitha këto që po thuhet këtu në këtë tekst, janë thënë në këtë seancë. I ka thënë edhe në fjalën hyrëse Sami Kurteshi. I kanë thënë të gjithë këtu me radhë, dhe asnjëri nuk ka problem në këtë.

Por, kjo mënyrë e futjes, në njëfarë mënyrë t'i fusësh hundët në këtë seancë që është thirrur, është plotësisht jo procedurale. Prandaj, do të ketë komision i cili do të shqyrtojë rezolutë dhe do ta sjellë në këtë Kuvend.

E tani, pse ekziston dyshimi mbi nismën e presidentit Hashim Thaçi në këtë rast. Për mua personalisht edhe për shumë të tjerë këtu, ka një dyshim në cilëndo nismë të tij, sepse kur del që ai këshilltarin e vet e ka njeri të BIA-s, më tregoni se pse ne duhet t'u besojmë rezolutave të tij. Ku e dimë se çfarë ka prapa tyre.

Prandaj, e përcjellim gjithmonë me hezitim. Me hezitim dhe frikë, sepse e ka pasur rastin sa ka negociuar në Bruksel e se ka çel gojën kurrë. Sepse, ka bërë marrëveshje të prillit në ndërkohë që ka pasur protesta edhe ka pasur diskriminim të shqiptarëve, dhe as njëherë asnjë çështje s'është ngritur.

Prandaj, ne nuk i besojmë dhe sidomos tash së fundi me këtë skandalin që e pati. Si mund t'i besojmë një personi që të na sjellë këtu, të na servojë rezoluta pa i shqyrtuar fare komisioni, i cili është i thirrur grupi punues për këtë punë.

Është grupi punues. Le ta bëjë rezolutën. Të gjitha këto çështje edhe çështje të tjera, jam i bindur që do të futen. Edhe referendumi i vitit '92. Edhe çështja e reciprocitetit. Edhe çështja e negociatave. Edhe çështja e përfshirjes së përfaqësuesve të Luginës në negociatat e ardhshme.

Këtë e kemi thënë të gjithë dhe po e themi vazhdimisht. E kemi thënë edhe më herët sa kanë qenë negociatat e mëparshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Më shumë edhe si sqarim, se jo kundër-replikë. Po mendoj për çështje procedurale e kemi Kuvendin, këta mund të na e shpjegojnë më saktë sesi duhet të përcillet një tekst ose një propozim.

Dhe, nëse është problem procedura, mua ma merr mendja që duhet dhe mund të përmirësohet.

Thashë, mund të bëhet edhe një seancë tjetër dhe të bëhen dy rezoluta ose t'i fuzionojmë. Vetëm se, është deklarata politike e datës 14 korrik 2018 e Kuvendit të këshilltarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës, ku në fjalinë e fundit thuhet se, Kuvendi i këshilltarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës, autorizon Presidencën, Qeverinë, Parlamentin e Republikës së Kosovës, që në bisedimet përmbyllëse etj, etj, të vendos mbi statusin politik, duke e marrë parasysh referendumin e marsit '92, dhe dispozita e platformës politike, janar 2006.

Nëse këto na i kanë kërkuar njerëzit që e përfaqësojnë Luginën më mirë se ne, unë veç po them se do të ishte mirë që të jetë pjesë e rezolutës përfundimtare.

KRYESUESI: Po, shiko! A bëjmë një punë? A bëjmë që të gjitha grupet parlamentare nga një diskutim rreth kësaj çështjeje? Pesë minuta, qëndrimin e grupit parlamentar edhe... Shiko! E drejta e presidentit është që të përpilojë dokumente dhe t'ia propozojë Kuvendit.

Por, ju e dini që presidenti s'mund të na detyrojë neve që të votojmë gjithçka, ndoshta çka s'duam ne që të votojmë. Është e drejtë e jona është që të mos votojmë edhe të votojmë. E drejtë e tij është që të propozojë. E, nuk e di atë. Unë nuk e di.

Po hapet debati pastaj. Kalojmë në këtë çështje që e kishim, pastaj nëse dëshironi diskutojmë edhe për këtë. Zoti Kurteshi, e ke fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Zoti nënkryetar, nëse kanë përfunduar diskutimet, më lejoni që në emër të grupit ta paraqesë rezolutën, nëse kanë përfunduar. Atëherë, a mund ta paraqesë?

Së pari, dëshiroj t'ju njoftoj se të gjitha grupet parlamentare kanë pasur përfaqësues në takim dhe ne e kemi shqyrtuar vetëm rezolutën të cilën ne e kemi iniciuar. Asnjë rezolutë tjetër, nuk është parë e arsyeshme nga asnjëri prej anëtarëve e atij grupi që të shqyrtohet sot.

Janë procedurat për të gjitha ato tekste të cilat sa që i kemi lexuar dhe as që po duam t'i diskutojmë, dhe ka mundësi që t'i sjellë në seancat tjera.

Tani, unë do t'i lexoj në emër të përfaqësuesve të të gjitha grupeve parlamentare pikat e kësaj rezolute dhe këtu është shkruar kështu:

1. Çështja e Luginës së Preshevës të bëhet pjesë e përhershme e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i informojë institucionet dhe forumet ndërkombëtare për politikën diskriminuese të shtetit të Serbisë që po ushtron ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës, në dialog me Serbinë të insistojë që shqiptarët e Luginës së Preshevës të gëzojnë të drejta të njëjta me ato të serbëve në Republikën e Kosovës.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës, t'i pajisë me dokumente identifikuese të Republikës së Kosovës, shqiptarët e Luginës së Preshevës që jetojnë në Kosovë.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, të kërkojë nga Republika e Serbia ta ndërpresë menjëherë pasivizimin e adresave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës.
6. Qeveria e Republikës së Kosovës të hapë përfaqësi diplomatike në Luginën e Preshevës.
7. Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ta hapë një zyrë për Luginën e Preshevës.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës, të ndajë fonde të përhershme zhvillimore nëpërmjet Këshillit Kombëtar Shqiptar për Luginën e Preshevës.
9. Qeveria e Republikës së Kosovës, të pajisë me tekste shkollore, mjete didaktike dhe lektura për shkollat shqipe në Luginën e Preshevës.
10. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të obligohet që ta zbatojë memorandumit e bashkëpunimit me Këshillin Kombëtar Shqiptar.
11. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë obligohet t'i rrisë kuotat për studentët nga Lugina e Preshevës në universitetet publike në Kosovë.
12. T'ju lejohet mjekëve që diplomojnë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë ta kryejnë praktikën në Kosovë dhe të pajisen me certifikata pune.
13. Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëpërmjet komisioneve parlamentare ta përcjellë gjendjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Këto janë pika që janë votuar me konsensus. Ka pasur edhe propozime të tjera të cilat nuk kanë kaluar. Prandaj, unë ju lus juve që si kryesues i kësaj seance ta qitni në votim këtë rezolutë, dhe pastaj për arsyen që e kemi thirru ne sot këtë mbledhje, mbledhja merr fund, e të tjerët le të thërrasin seanca të tjera dhe le të dalin me iniciativa të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I lus deputetët që të futen në sallë. Nuk ka diskutime më. Kanë diskutuar të gjithë. Është miratuar në komision. Mund ta votojmë ose të mos e votojmë.

Çfarë të bëj unë tani. A po dëshironi që ta vazhdojmë debatin përsëdyti, ta fillojmë? Nëse duam të vazhdojmë, gjë që kurrë nuk ka qenë as nuk është praktikë që pasi të kryhet diskutimi, të fillojnë diskutimet.

Votoni kundër, çfarë të bëj.

S'ka kuorum apo? S'ka kuorum. Unë do t'ju lusja që vërtetë ta shihni tekstin, ta përpunoni për seancën e ardhshme kur ta thërrasim edhe e votojmë, meqenëse s'ka kuorum.

Ismajli e ka thënë tekstin, por nuk domethënë që mbetet ky tekst. Ju kisha lutur që kryetarët e grupeve ose disi takohuni dhe ndërrojeni tekstin, se s'e kam ndërmend ta filloj debatin.

Mirupafshim në seancën e radhës. Gjithë të mirat! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*